

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5922
E martë, 5 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Jo të gjithë i gëzohen
Ligjit për pagat | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ARTAN MUHAXHIRI | FAQE 4-5

PRITJET NGA QEVERIA LV - LDK NUK DUHET TË JENË TË MËDHA

Analisti politik Artan Muhaxhiri ka vlerësuar se procesi i themelimit të qeverisë së re nuk është i lehtë, por kërkon angazhime të mëdha shumështrësore. Ai ka thënë se, pavarësisht prej dallimeve, LV-ja dhe LDK-ja detyrimisht do të bëjnë kompromise në aspektin ideologjik për ndarjen e pushteteve konkrete si dhe për modifikimin e pozicioneve të deritashme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Muhaxhiri ka deklaruar se pritjet nga qeveria LV - LDK nuk duhet të jenë të mëdha sepse një pjesë e zinxhirit të sistemit institucional është deformuar strukturalisht dhe kjo nënkupton që korrigjimi i tij do të kërkojë kohë dhe angazhim konstruktiv. Sipas tij, një ndër punët më të vështira të qeverisë së re do të jetë krijimi i besimit të qytetarëve në shtet. Kurse sa i përket dialogut, Muhaxhiri ka theksuar se investimi i shtuar amerikan me emisarët e posaçëm çon drejt presionit për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020



OPINION

**ZVARRITJET
PAARSYESHMËRISHT TË
ARSYETUARA TË FORMIMIT
TË INSTITUCIONEVE
NGA LV-ja DHE LDK-ja F. 7**

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



**IDEALE TË AFRIM ZHITISË
DHE FAHRI FAZLIUT ISHIN
LIRIA, REPUBLIKA DHE
BASHKIMI F. 7**

Sabri
KIÇMARI



Palmeri: Të respektohet rezultati i zgjedhjeve në Kosovë | FAQE 3



Zëvendësndihmësi i sekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe përfaqësuesi i posaçëm për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, gjatë vizitës në Beograd ka thënë të hënën se është e rëndësishme që rezultati i zgjedhjeve në Kosovë të re spektrohet. "Në Kosovë ka vend për shumë zëra të ndryshëm që duhen dëgjuar, por është e rëndësishme të respektohen rezultatet e zgjedhjeve", ka deklaruar Palmeri



**Konjufca:
Brenda dy
javësh do të
përfundojnë
negociatat
për
formimin e
qeverisë**
| FAQE 7



**NAIT HASANI MERR DETYRËN
E AMBASADORIT TË KOSOVËS
NË SHQIPËRI F. 6**

EKONOMI

**KMDLNJ-JA E KUNDËRSHTON
VENDIMIN E BQK-SË PËR
RISHIKIMIN E TARIFAVE PËR
SIGURIM TË VETURAVE F. 9**

**KEDS-I VENDOS TETË TRAFO TË
REJA NË KLINË TË SKENDERAJT**
F. 9

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kurti takohet me Zaevin

PRISHTINË, 4 TETOR - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër, Albin Kurti është takuar të hënën në Shkup me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev me të cilin ka biseduar për situatën politike dhe për bashkëpunimin ndër-

shtetëror.

"Sot në Shkup takova kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, me bashkëpunëtorët e tij. I shoqëruar nga anëtarët e Kryesisë, Fitore Pacolli-Dalipi dhe Liburn Aliu, biseduam për situatën politike në dy vendet tona,

mundësitë e bashkërendimit të ndërsjellë, raportet midis shteteve në Ballkan dhe çështjet e integritimit evropian. Do të mbetemi në komunikim të vazhdueshëm për takime e bashkëpunime në të ardhmen", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".



Polemikat për hetimin e presidentit Trump

Disa demokratë thonë se republikani Trump, i cili ka udhëzuar zyrtarët e administratës që të mos bashkëpunojnë, duhet të përballet me akuzën e pengimit të drejtësisë, në listën e akuzave që ata planifikojnë të ngrenë ndaj tij si pjesë e procesit të shkarkimit



WASHINGTON, 4 NËNTOR - Presidenti amerikan Donald Trump, i cili përballet me një hetim në rritje nga demokratët që përpiqen ta shkarkojnë, tha të hënën se përgjigjet me shkrim nga ana e informatorit që u bë shkak për hetimin nuk janë të mjaftueshme.

Një informator në Shtëpinë e Bardhë ishte i pari që bëri të ditur se gjatë një bisede në korrik të këtij viti, Trumpi ushtroi presion mbi Ukrainën që ajo të hetonte njërin prej rivalëve të tij politikë demokratë për zgjedhjet e 2020-s, ish-nën-presidentin Joe Biden.

Presidenti Trump tha në Twitter se informatori "duhet të sillet për të dëshmuar". "Përgjigjet me shkrim nuk pranohen!" Ai e quajti hetimin për shkarkimin e tij një farsë.

Një ditë më parë, avokati i informatorit, Mark Zaid, tha se klienti i tij, i cili mbetet anonim, është i gatshëm t'u përgjigjet me shkrim pyetjeve të

mbështetësve republikanë të presidentit Trump, por jo pyetjeve për identitetin e tij. Presidenti Trump shkruante gjithashtu në Twitter se: "Ajo që thashë në bisedën telefonike me presidentin e Ukrainës u deklarua në mënyrë të përkryer. Nuk ka asnjë arsye për t'i thirrur dëshmitarë për të analizuar fjalët dhe kuptimet e mia. Kjo është thjesht një tjetër farsë e demokratëve, me të cilën më është dashur të përballem nga dita kur u zgjodha. E turpshme!"

Ndërkaq, disa persona të thirrur për të dëshmuar të hënën gjatë javës në hetimin që synon ngritjen e akuzave për shkarkimin e presidentit Trump, nuk po i binden kërkesës së ligjvënësve demokratë për t'u paraqitur në seanca me dyer të mbyllura, para se hetimi të kalojë në fazën publike.

Ata kanë refuzuar të paraqiten para komisionëve të drejtuara

nga demokratët në Dhomën e Përfaqësuesve, duke rritur më tej tensionet midis Shtëpisë së Bardhë dhe ligjvënësve lidhur me kompetencat ligjore të këtyre të fundit për të kryer hetime.

Disa demokratë thonë se republikani Trump, i cili ka udhëzuar zyrtarët e administratës që të mos bashkëpunojnë, duhet të përballet me akuzën e pengimit të drejtësisë, në listën e akuzave që ata

planifikojnë të ngrenë ndaj tij si pjesë e procesit të shkarkimit.

Tre zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë, përfshirë drejtorin në detyrë të buxhetit, nuk pranojnë të paraqiten, tha një zyrtar i lartë i administratës. Dëshmia e tyre shihet si e një rëndësie kritike për të përcaktuar nëse presidenti Trump përdori ndihmën e huaj për Ukrainën si mjet për të siguruar një favor politik dhe për të diskredituar

rivalin Biden në zgjedhje.

Presidenti mohon se ka kryer ndonjë shkelje.

Ndërkohë një gjykatë apeli e Nju Jorkut urdhëroi presidentin Trump t'iu dorëzojë prokurorëve dokumentet e taksave të tetë vjetëve të shkuara, duke hedhur poshtë përpjekjet e tij të vazhdueshme për të mos deklaruar financat. Një avokat personal i Trumpit deklaroi se do ta apelojë vendimin në Gjykatën e Lartë të vendit.

Basha: Katër oligarkët e Ramës po vjedhin gjithçka

TIRANË, 4 NËNTOR - Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka nisur të hënën turin e bashkëbisedimeve me qytetarët. Ndalea e parë ishte Elbasani, ku kreu i PD-së zhvilloi një takim me të rinjtë. Basha u shpreh se problemi më i madh që ka sot vendi është emigrimi i të rinjve. "Humbja potenciale për ekonominë shqiptare nga emigracioni për 2018-ën është 590 milionë euro. Ky është problemi më i madh, hemorragji për vendin. Shumica larohen për kushte të mira jetese", tha Basha.

Kreu i PD-së tha se problemet që kanë sot të rinjtë vijnë nga modeli i gabuar qeverisës. Basha u shpreh se sot 4 oligarkët kontrollojnë gjithë tenderët dhe ekonominë e vendit. "Ju e dini fare mirë se kë vlerëson kjo qeveri. Këtu në Elbasan, kur e bardha ka qenë e bardhë dhe e zeza e zeze, policia ka mbajtur krahun e banditit. E para që duhet të marrë fund është modeli. Ndaj ne do ndryshojmë modelin, ndarjen e pushtetit nga krimi. Para dy javësh BE-ja dhe Gjermania thanë që të ecni dhe të vini te ne duhet t'i jepni fund poli-

tikës të lidhur me krimin. Duhet të ofroni mundësinë dhe të gjithë shqiptarë të barabartë para ligjit. 4 oligarkët e qeverisë nuk kanë ide më të mira, por sot ata kontrollojnë ekonominë sepse ata marrin tenderët, PPP dhe pasuritë e shqiptarëve. Çdo student me të ardhura të ulëta do të përfitojë 100 bursë. Kush ka të ardhura mbi 640 mijë lek në muaj, bursë 50%", tha Basha.

Kreu i PD-së tha se opozita ka projekte që do të rikthejnë shpresën te të rinjtë dhe do të ndikojnë në rritjen ekonomike.



Palmeri: Të respektohet rezultati i zgjedhjeve në Kosovë

Zëvendësndihmësi i sekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe përfaqësuesi i posaçëm për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, gjatë vizitës së tij në Beograd ka thënë të hënën se është e rëndësishme që rezultati i zgjedhjeve në Kosovë të respektohet. "Unë mendoj se në Kosovë ka vend për shumë zëra të ndryshëm që duhen dëgjuar, por është e rëndësishme të respektohen rezultatet e zgjedhjeve", ka deklaruar Palmer

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Zëvendësndihmësi i sekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe përfaqësuesi i posaçëm për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, ka thënë të hënën në Beograd, se është e rëndësishme që rezultati i zgjedhjeve në Kosovë të respektohet. Me këtë rast, ai ka pohuar se subjekti politik Lista Serbe ka marrë mbështetjen e shumicës së serbëve të Kosovës në zgjedhjet e 6 tetorit dhe se me këtë e ka fituar të drejtën për t'u përfaqësuar në Qeverinë e Kosovës. "Unë mendoj se në Kosovë ka vend për shumë zëra të ndryshëm që duhen dëgjuar, por është e rëndësishme të respektohen rezultatet e zgjedhjeve", ka deklaruar Palmer.

Palmeri i bëri këto komente pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, me të cilin tha se ka diskutuar për situatën politike në Serbi dhe rajon. Palmeri ka theksuar se vendimi i Bashkimit Evropian për të mos caktuar një datë për fillimin e bisedimeve të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë ishte gabim historik. "Sipas mendimit tonë, ky është një gabim historik dhe një mesazh i keq për rajonin", ka pohuar Palmeri.

Ai ka deklaruar se ShBA-ja do

një perspektivë evropiane për Ballkanin Perëndimor dhe tha se do të punojë për t'i bindur udhëheqësit e BE-së që ta bëjnë këtë përpara Samitit të Zagrebit. "Amerika dëshiron që Ballkani Perëndimor të ketë një perspektivë evropiane dhe ne do të bëjmë gjithçka që mundemi për ta bindur Bashkimin Evropian që ta ndryshojë pozicionin përpara takimit të udhëheqësve të Bashkimit Evropian në Zagreb, në maj", ka thënë ai.

Palmeri ka treguar se me Vuçiqin ka diskutuar për situatën politike jo vetëm në Serbi, por edhe në rajon. Palmeri javën e kaluar ka vizituar edhe Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën, ku është takuar me zyrtarët e atjeshëm.

Zëvendësndihmësi i sekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe përfaqësuesi i posaçëm për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, gjatë vizitës në Prishtinë ka rikonfirmuar qëndrimin amerikan në mbështetje të pavarësisë, duke thënë se shtetësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe tani i duhet normalizimi. Ai ka theksuar se nuk shihet përparim për integrimin e Kosovës dhe rajonit pa arritjen e marrëveshjes për normalizimin e raporteve me Serbinë. "Shtetësia juaj është e pakthyeshme dhe tani ju duhet normalizimi. Shtetet e



Bashkuara të Amerikës do ta përkrahin gjithmonë sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës, por ne nuk shohim kurrfarë mundësie për integrimin e plotë të vendit tuaj në sistemin ndërkombëtar nëse nuk përfshin pajtimin me Serbinë", ka deklaruar Palmeri. Ai ka thënë se ShBA-ja e nxit qeverinë e re të Republikës së

Kosovës që, krahas prioriteteve të brendshme, të merret edhe me dialogun me Serbinë dhe me arritjen e marrëveshjes për normalizimin e raporteve. "Në vend se ta shohim dialogun si shpërqendrim, konsiderojeni normalizimin si trasim për prosperitet dhe drejtësi. Dialogu dhe normalizimi i raporteve me Serbinë çojnë Kosovën dhe

rajonin kah e ardhmja. Marrëdhëniet e përparuar dhe përmirësimi i tyre me Serbinë hapin rrugën për investime fitimprurëse që krijojnë vende të reja të punës prej të cilave mund të përfitojë populli i Kosovës. Kur të formohet qeveria me mandat të ri nga votuesit, mundet dhe duhet t'i gjallërojë negociatat", është shprehur Palmeri.



Nait Hasani merr detyrën e ambasadorit të Kosovës në Shqipëri

TIRANË, 4 NËNTOR (ER) - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur të hënën në një takim ambasadorin e ri të Republikës së Kosovës në Shqipëri, Nait Hasani, me rastin e paraqitjes së Letrave Kredenciale. Pasi e uroi për marrjen e detyrës, presidenti Meta e siguroi ambasadorin Hasani për

mbështetjen e plotë për kryerjen me sukses të misionit të tij në Tiranë.

Presidenti Meta gjatë këtij takimi ka vlerësuar procesin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit 2019 si tregues i maturisë politike, demokratike dhe institucionale të Kosovës. Meta u shpreh se marrëdhëniet dypalëshe në

mes të Shqipërisë dhe Kosovës janë të shkëlqyera dhe vlerësoi se bashkëpunimi midis dy vendeve është stabilizues për rajonin dhe motivues për perspektivën euroatlantike. "Liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës është i domosdoshëm dhe duhet të realizohet sa më parë", ka thënë presidenti Meta.

Flet për "Epokën e re", Artan Muhaxhiri

Pritjet nga qeveria LV - LDK



Analisti politik Artan Muhaxhiri ka vlerësuar se procesi i themelimit të qeverisë së re nuk është i lehtë, por kërkon angazhime të mëdha shumështrësore. Ai ka thënë se, pavarësisht prej dallimeve, LV-ja dhe LDK-ja detyrimisht do të bëjnë kompromise në aspektin ideologjik, në ndarjen e pushteteve konkrete si dhe në modifikimin e pozicioneve të deritashme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Muhaxhiri ka deklaruar se pritjet nga qeveria LV - LDK nuk duhet të jenë të mëdha sepse një pjesë e zinxhirit të sistemit institucional është deformuar strukturalisht dhe kjo nënkupton që korrigjimi i tij do të kërkojë kohë dhe angazhim konstruktiv. Sipas tij, një ndër punët më të vështira të qeverisë së re do të jetë krijimi i besimit të qytetarëve në shtet. Kurse sa i përket dialogut, Muhaxhiri ka theksuar se investimi i shtuar amerikan me emisarët e posaçëm çon drejt presionit për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në gjashtëmuorin e parë të vitit 2020

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Analisti politik Artan Muhaxhiri ka thënë të hënën se rezultati zgjedhor i 6 tetorit mund të konsiderohet si vlerësim preciz i qytetarëve për qeverisjen e kaluar dhe inicim i ndryshimeve dhe rikonfigurimeve të domosdoshme përbrenda spektrit politik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se votuesi e dënoi mediokritetin (anti)institucional, kokëfortësinë bllokuese dhe fudullëkun korruptues, duke dhënë kështu

një leksion demokracie. Muhaxhiri ka vlerësuar se procesi i themelimit të qeverisë së re kërkon angazhime të mëdha shumështrësore për arritjen e caktuar. Sipas tij, Vetëvendosja dhe LDK-ja detyrimisht do të bëjnë kompromise në aspektin ideologjik, në ndarjen e pushteteve konkrete si dhe në modifikimin e pozicioneve të deritashme. "Dy aleatët do të jenë të obliguar të lëvizin nga udhëkryqet ideologjike ku gjenden aktualisht, kurse një problematikë shtesë mund të paraqesë reduktimi i paralamëruar i numrit të ministrave në


Klinika e ORL-së në QKUK pajiset me aparaturë moderne

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Klinika e ORL-së në Qendrën Klinike Universitare është pajisur me aparaturë moderne, të kohës së fundit, të cilat i kanë vetëm spitalet perëndimore. "Në përpjekjet e saj të vazhdueshme për ta rritur kualitetin e shërbimeve, ShSKUK ka furnizuar Klinikën e ORL-së me një bronkoskop dhe një ezofagoskop.

Bronkoskopi është një pajisje me të cilën mjekët largojnë trupa të huaj në rrugët e frymëmarrjes. Me funksion të ngjashëm, ezofagoskopi, ndërkaq, kryen ndërhyrje në pjesën fillestare të rrugëve të tretjes. Aparatura e re krijon lehtësi dhe ofron më shumë siguri për mjekët gjatë intervenimit të pacienti", është bërë me dije në njoftimin e

QKUK-së.

Në komunikatë theksohet se furnizimi i Qendrës Klinike Universitare dhe spitaleve të përgjithshme me aparaturë të re është parë si nevojë e domosdoshme nga menaxhmenti i ShSKUK-së për t'i përmirësuar shërbimet për pacientët dhe kushtet për profesionistët shëndetësorë.



nuk duhet të jenë të mëdha



12, pasi kjo do të nënkuptojë edhe zvogëlim të pushtetit potencial", ka theksuar ai, duke shtuar se pritet nga qeveria LV-LDK nuk duhet të jenë të mëdha sepse, sipas Muhaxhirit, një pjesë e zinxhirit të sistemit institucional është deformuar strukturalisht dhe kjo nënkupton që korrëgjimi i tij do të kërkojë kohë dhe angazhim konstruktiv. Ai ka thënë se një ndër punët më të vështira dhe më të rëndësishme të qeverisë së re do të jetë krijimi i besimit të qytetarëve në shtet. Kurse në kontekstin e dialogut, Muhaxhiri ka theksuar se investimi i shtuar amerikan me

emisarët e posaçëm çon drejt presionit për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në gjashtëmuorin e parë të vitit 2020.

"Epoka e re": Z. Muhaxhiri, si e keni parë rezultatin zgjedhor të 6 tetorit. Ka qenë i pritshëm?

Muhaxhiri: Rezultati zgjedhor i 6 tetorit mund të konsiderohet vlerësim preciz i qytetarëve për qeverisjen e kaluar dhe inicim i ndryshimeve dhe rikonfigurimeve të domosdoshme përbrenda spektrit politik kosovar. Me baraspeshim racional votuesi e dënoi mediokritetin (anti) institucional, kokëfortësinë

bllokuese dhe fudullëkun korruptues, duke dhënë kështu një leksion demokracie. E mira e standardit të krijuar më 6 tetor është se ai mund të shndërrohet në kriter orientues për pritshmëritë elektorale të herëve të tjera.

"Epoka e re": Bazuar në këtë rezultat, Vetëvendosja dhe LDK-ja kanë filluar negociatat për arritjen e koalicionit qeverisës. Si e shihni formimin e qeverisë së re?

Muhaxhiri: Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kanë dallime të konsiderueshme konceptuale, ideologjike dhe funksionale. Mirëpo, të dyja partitë detyrimisht do të bëjnë kompromise si në aspektin ideologjik, po ashtu edhe në ndarjen e pushteteve konkrete dhe në modifikimin e pozicioneve të deritashme. Procesi i themelimit të qeverisë nuk është i lehtë as për parti të cilat kanë shumë më pak dallime mes tyre, prandaj kësaj radhe do të duhet të ketë angazhime të mëdha shumështrësore për arritjen e cakut qeveritar. Logjikisht, të gjitha dallimet kuptimplote duhet të identifikohen dhe adresohen para arritjes së marrëveshjes për bashkëqeverisje në mënyrë që pastaj të mos transformohen në pengesa. Dy aleatët do të jenë të obliguar të lëvizin nga udhëkryqet ideologjike ku gjenden aktualisht, kurse një problematikë shtesë mund të paraqesë reduktimi i paralajmëruar i numrit të ministrive në 12, pasi kjo do të nënkuptojë edhe zvogëlim të pushtetit potencial.

"Epoka e re": Në këtë drejtim mund të priten pengesa nëse merren parasysh deklarimet e fundit nga nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, se posti i kryeministrit kalon nëpër zyrat e kësaj partie?

Muhaxhiri: Debat i këtyllë është skajshmërisht naiv sepse e cenon energjinë bashkëpunuese dhe e zhvendos fokusin prej çështjeve kryesore. Konteksti për

krijimin e qeverisë është kristal i qartë si në aspektin politik, po ashtu edhe në atë kushtetues. Votuesi kosovar vullnetshëm dhe pa ekuivokë u ka përcaktuar bashkëpunimin Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, prandaj këto dy subjekte e kanë pothuajse të detyrueshëm institucionalizimin e kësaj fryme politike. Në të kundërtën, nuk do të kishin asnjë kredi morale që në të ardhmen të kërkonin votë në emër të ndryshimit. Tendencat individuale për përfitimin e vëmendjes mediale me qëndrime militante partiake tregojnë nivel të ulët të vetëdijes politike ndaj peshës së madhe shoqërore të këtij momentumi të veçantë në historinë e re të Kosovës.

"Epoka e re": Cilat janë pritet e juaja për funksionimin e qeverisë LV-LDK nëse u referohemi dallimeve që i kanë këto dy parti?

Muhaxhiri: Pritjet nga qeveria LV-LDK nuk duhet të jenë të mëdha sepse një pjesë e zinxhirit të sistemit institucional është deformuar strukturalisht dhe kjo nënkupton se korrëgjimi i tij do të kërkojë kohë dhe angazhim konstruktiv. Ajo që është brenda kufijve të së mundshmes për këtë koalicion ka të bëjë me kthimin e normalitetit qeverisës: trajtimin meritot të problemeve të qytetarëve në proporcion me rëndësinë jetike, emërimin e personaliteteve të duhura për udhëheqjen e dikastereve, mënyrën transparente të shpenzimit të parasë publike, si dhe ofrimin e mundësive të barabarta mbi parimet objektive e të padeterminuara nga përkatësitë partiake. Sa i përket imazhit të qeverisjes, qeveria e re nuk do ta ketë shumë të vështirë ta rregullojë atë pasi tashmë është dërrmuar përtokë nga qeveria e kaluar.

"Epoka e re": Qeveria e re, me çfarë sfidash do të ballafaqohet gjatë mandatit katërvjeçar?

Muhaxhiri: Është utopike të mendohet se problemet e

panumërta që janë akumuluar gjatë dy dekadave të kaluara do të mund të zgjidhen shpejt dhe me lehtësi nga qeveria e re. Për këtë arsye kërkohet një prioritetizim shtetëror i agjendës vepruese dhe qasje panoramike e ndërhyrjeve dhe investimeve institucionale. Planifikimet do të duhet të bëhen për ndryshime graduale sistemore, jo të ashpra dhe traumatike. Përtej domosdoshmërisë së angazhimit për normalizimin e sistemit ligjor, zvogëlimin e papunësisë, rritjen e mirëqenies, përmirësimin e shëndetësisë dhe arsimit, një ndër punët më të vështira dhe më rëndësishme të qeverisë së re do të jetë krijimi i besimit të qytetarëve në shtet. Qeverisjet e kaluara e kanë dëmtuar këtë besim për shkak të injorimit të kërkesave për ngritje të kualitetit të jetesës dhe e kanë zymtësuar perspektivën për jetë në Kosovë, gjë që ka rezultuar me rritje të gatishmërisë së qytetarëve për largim nga vendi.

"Epoka e re": Si e shihni ecurinë e dialogut, agjendës evropiane dhe proceseve të tjera të rëndësishme në aspektin e brendshëm nën drejtimin e qeverisë Kurti?

Muhaxhiri: Përparësia e qeverisë Kurti do të jetë në faktin se nuk do të ketë shumë paqartësi as sa iu përket sfidave të brendshme, as atyre të jashtme. Do të mbetet çështje ekskluzive e saj se si do të rreshtohet karshi tyre, mirëpo nuk do të ketë të drejtë të befasohet. Në kontekstin e dialogut, investimi i shtuar amerikan me emisarët e posaçëm çon drejt presionit për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në gjashtëmuorin e parë të vitit 2020. Maksimalizimi realist i përfitimeve politike për Kosovën përbrenda konstalacioneve gjeopolitike dhe gjeostrategjike do të duhej të ishte synim strategjik i qeverisë. Rrjedhimisht, niveli i konstruktivitetit në dialog do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në dinamikën e rrugës evropiane të Kosovës. Këto zhvillime do ta përcaktojnë në masë të konsiderueshme suksesin dhe jetëgjatësinë e qeverisë Kurti.

Thaçi: Kosova ka dëshmuar zotësi në luftën kundër terrorizmit

Prishtinë, 4 nëntor (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se vlerësimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për vendin tonë në luftën kundër terrorizmit është impresionues. Thaçi nëpërmjet një videoje të publikuar në llogaritë e veta në "Facebook" dhe "Instagram" ka thënë se një

vlerësim i tillë është i merituar. Presidenti Thaçi ka thënë se Kosova ka dëshmuar zotësi në luftën kundër terrorizmit dhe fundamentalizmit. "Vlerësimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në luftën kundër terrorizmit është impresionues. Një vlerësim, ky i merituar, sepse Kosova ka vite që dëshmohej edhe

praktikisht në luftë kundër terrorizmit, fundamentalizmit dhe çdo lloj ekstremizmi që paraqitet në Kosovë në rajon apo jashtë rajonit, kudo në botë, së bashku me partnerët ndërkombëtarë. Kosova ka dëshmuar zotësi, aftësi dhe djemtë e vajzat e saj kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm", ka deklaruar Thaçi.



Studentët paralajmërojnë bojkotim të mësimit, shkak konkursi i MASHT-it për bursa

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Këshilli Studentor i Fakultetit të Arteve, që udhëhiqet nga organizata studentore "Reforma", ka protestuar të hënën kundër vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për konkursin e bursave për studentët e Universitetit të Prishtinës.

Kryetari i këtij këshilli, Edison Bibaj, ka kërkuar nga Ministria e Arsimit që ta anulojë vendimin për bursa, përndryshe do të vazhdohet bojkotimi i mësimit deri në rishqyrtimin e këtij vendimi. "Sot para Ministrisë së Arsimit po fillojmë një protestë për të vetmen arsye, që është keqtrajtimi i studentëve në aspektin e bursave studentore. Bursa e ministrisë nuk është e përfshirë në të gjitha njësitet akademike. Ne jemi të dëshpëruar dhe për këtë arsye kemi vendosur ta fillojmë këtë protestë. Të enjten kemi bërë këtë kërkesë pranë Ministrisë së Arsimit që të kemi një sqarim se për çfarë arsye Fakulteti i Arteve nuk është i përfshirë në radhët e fakulteteve ku merren bursa për studentë,



mirëpo nuk kemi marrë asnjë arsyetim apo sqarim", është shprehur Bibaj.

Ai ka thënë se kompromisi i vetëm i tyre është anulimi i konkursit nga ana e MASHT-it. "Kërkesa jonë është që ky vendim të rishqyrtohet sepse nuk do të pranohet në asnjë mënyrë. I vetmi kompromis është që ky vendim të anulohet. Në asnjë mënyrë nuk pranojmë që me këtë vendim të ecet përpara". "Kjo është protestë që paralajmëron se

nga nesër do ta vazhdojmë bojkotimin e mësimit deri në rishqyrtimin e vendimit për bursa. Ne do t'i bllokojmë njësitet akademike dhe nuk do të mbajmë ligjëratat qoftë edhe një vit. Ky është vendim i pakompromis", ka deklaruar Bibaj.

Ndërkaq Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka njoftuar se ka planifikuar që edhe këtë vit bursat që do t'u ndahen studentëve ta kenë shumën e bursave që janë ndarë

edhe vitin e kaluar (880 euro). "Mbështetja e studentëve me bursa ka për qëllim përkrahjen e kadrove deficitare, prandaj janë zgjedhur për mbështetje financiare vetëm fakultetet të cilat përgatisin kadro deficitare. Fakulteti i Edukimit dhe ai i Arteve nuk konsiderohen më si deficitare, prandaj studentët e këtyre fakulteteve nuk do të mbështeten financiarisht nga MASHT-i. Këtë vit MASHT-i ka ulur kriterin e notës mesatare

për studentët e Fakultetit Teknik sepse, përveç që ky fakultet përgatit kadro që në tregun e punës ka mungesë të theksuar, disa drejtime rrezikojnë të mbyllen për mungesë interesimi për të studiuar në këto drejtime", është thënë në reagimin e MASHT-it.

Me këtë rast, Ministria e Arsimit ka kërkuar nga organizatat të cilat përfaqësojnë studentët, që të mos manipulojnë studentët në lidhje me këtë çështje.

400 mijë euro ndahen për ndërtimin e Parkut Memorial të UÇK-së në Jezerc



PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka pritur të hënën në takim kryetarin e Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, me të cilin kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për realizimin e projektit "Ndërtimi i Parkut Memorial të UÇK-së në Jezerc-Ferizaj", në vlerë prej 400 mijë eurosh, të financuar nga MMPH-ja.

Në ceremoninë e nënshkrimit të këtij memorandum ministri Matoshi ka deklaruar që si ministër i MMPH-së në vazhdimësi ka përkrahur komunat e

Kosovës për rritjen e performancës dhe arritjen e synimeve të tyre. "Me këtë projekt ne do të arrijmë që të kemi një kujdes më të madh për dëshmorët e rënë në luftën tonë për liri", ka vlerësuar ministri Matoshi.

Ndërsa kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka falënderuar ministrin Matoshi për përkrahjen që ky i fundit po i jep Komunës së Ferizajt dhe ka vlerësuar se ky projekt është mjaft i rëndësishëm marrë parasysh historinë që përfaqëson, kontributin dhe sakrificën e dhënë nga ushtarët e UÇK-së për lirinë e Kosovës.

Filloi puna për rehabilitimin e rrugës Pantinë - Oshlan

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Ministri i Infrastrukturrës dhe Transportit, Pal Lekaj, mori pjesë të hënën në fillimin e punimeve për rehabilitimin e rrugës Pantinë - Oshlan në Vushtrri. Lekaj ka theksuar se fillimi i këtij projekti simbolizon përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe në zhvillimin e projekteve infrastrukturore lokale, para së gjithash përmirësimin e jetës së

qytetarëve të kësaj ane. Ky projekt është financim i MIT-së dhe ka kosto 827 163 euro. Me gjatësi prej 2.7 kilometrash, brenda këtij projekti përfshihen: zgjerimi i rrugës, asfaltimi me dy shtresa, trotualet, sinjalistika horizontale dhe ajo vertikale, si dhe lëshesat gypore përgjatë rrugës. MIT-ja gjatë qeverisë Haradinaj ka zhvilluar rreth 300 projekte infrastrukturore në mbarë vendin.



Jo të gjithë i gëzohen Ligjit për pagat

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Rreth 23 mijë shërbyes civilë në administratën lokale dhe qendrore të Kosovës po shprehin pakënaqësitë e tyre lidhur me Ligjin e ri për paga, i cili është miratuar në shkurt të këtij viti, kurse ka hyrë në fuqi më 2 nëntor të këtij viti. Sipas këtij ligji, rreth 70 për qind e punëtorëve në sektorin publik nga muaji dhjetor pritet që t'i marrin pagat me rritje.

Kryetari i Sindikatës së Shërbimit Civil të Kosovës, Mursel Zymberi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se shërbyesit civilë ndihen të diskriminuar dhe nuk trajtohen të barabartë sa i përket nivelit të pagave. Ai ka thënë se me Ligjin e ri për pagat, shërbyesit civilë mbesin në koeficientin shumë të ulët, respektivisht rritje të vogël të pagave. Ai kërkon që shërbyesit civilë të sistemohen mbi bazën e kontributeve të punës dhe pozitës që kanë në vend të punës. "Pakënaqësitë e shërbyesve civilë kanë filluar të shprehen, por fillimi i pranimit

të pagave do të manifestohet me një pakënaqësi shumë të madhe sepse dihet dallimi i madh i pagave në mes të shërbyesve publikë në përgjithësi. Ata janë të pakënaqur sepse në kuadër të shërbimit civil ka shumë sektorë që bëjnë punë profesionale dhe mbi bazën e Ligjit të profesioneve ata do të duhet të paguhen sikur sektori tjetër i shëndetësisë dhe i arsimit", ka thënë Zymberi.

Paga mesatare e shërbyesve civilë në Kosovë, sipas Zymberit, është 370 euro në muaj, kurse me ligjin e ri disa prej shërbyesve civilë pagat mund t'i marrin me një rritje prej 40 euro në muaj. Kjo sindikatë edhe para nënshkrimit të Ligjit për pagat, më 2 shkurt të këtij viti, ka mbajtur disa greva, ndërkohë që kishte kërkuar nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, që të mos e ratifikojë Ligjin për paga. Zymberi tregon se sindikata kishte deponuar edhe një ankesë zyrtare në lidhje me Ligjin për pagat tek institucioni i

Avokatit të Popullit në Kosovë. Përveç Sindikatës së Shërbyesve Civilë, Avokati i Popullit në Kosovë deri më tani ka pranuar edhe 17 ankesa të tjera lidhur me Ligjin për pagat në sektorin publik, ku nuk përfshihen vetëm sindikatat, por edhe grupe ankuesish të ndryshëm të cilët konsiderojnë se Ligji për pagat ndikon negativisht në interesat e tyre. Këtë e ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë", Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, duke thënë se "ankesat e paraqitura tek Avokati i Popullit janë të ndryshme, varësisht nga pozita dhe institucionet që kanë paraqitur ankesë, përmes të cilave shfaqen pakënaqësitë lidhur me përcaktimet dhe përfshirjen e tyre në Ligjin për pagat në sektorin publik", ka thënë Jashari. Mursel Zymberi thotë se trajtimi diskriminues i institucioneve shtetërore ndaj shërbyesve civilë do të ndikojë edhe në punën e sektorëve të tjerë. Sidoqoftë, në Ministrinë e

Financave zyrtarët e saj kanë konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se nga muaji dhjetor do të zbatohet Ligji për pagat dhe se pagat e kategorive të përfshira do të dalin me rritje nga dhjetori.

Numri i punonjësve që marrin paga nga buxheti i Kosovës është rreth 82 mijë veta. Paga mesatare në sektorin publik, sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2018 ishte 573 euro. Sipas ligjit të ri, paga mujore më e ulëta është ajo e shtëpiakut prej 322 eurosh, 621 euro është paga e mësimit të shkollës së mesme, profesori i universitetit do të marrë 1 505 euro, kryeprokurori 1 912 euro, kryeministri 2151 dhe presidenti i Kosovës nga muaji dhjetor do ta marrë pagën mujore në vlerë prej 2 390 eurosh. Kështu paraqiten pagat bazë dhe nuk përfshihen kompensimet shtesë, si puna jashtë orarit ose rrezikshmëria. Sipas ligjit të ri, paga bazë është

ajo pjesë e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë të një funksioni apo pozite të caktuar. Vlera e pagës bazë llogaritet duke shumëzuar koeficientin e klasës së pagës me vlerën monetare të koeficientit. Raporti i koeficienteve është një me dhjetë (1:10), të shpërndarë në gjashtëdhjetë e nëntë (69) nivele të koeficientëve.

Koeficienti më i lartë është 10, pozitë kjo që e mban vetëm presidenti i Republikës së Kosovës, më pas është niveli i 9, ku bëjnë pjesë kryetari i Kuvendit, kryeministri dhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në koeficientët nga 1.85 deri 2.25 janë pozita të ndryshme të shërbyesve civilë, nga 2.5 deri në 5 janë përfshirë nga infermieri e deri te mjeku specialist. Ndërkaq, më poshtë, në pozitat nga 1.7 deri në 2.5, përfshihen përfaqësues të sistemit të arsimit, bashkë me edukatorët e kopshteve deri te drejtorët e shkollave të mesme.



Konjufca: Brenda dy javësh do të përfundojnë negociatat për formimin e qeverisë

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Të hënën janë takuar sërish grupet punuese të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për të diskutuar për shëndetësinë dhe arsimin në kuadër të formimit të qeverisë së re. Pas këtij takimi, ka folur Glauk Konjufca, i cili ka thënë se brenda dy javësh do të përfundojnë negociatat për formimin e qeverisë. "Sot jemi mbledhur për të biseduar për shëndetësinë dhe arsimin.

Grupet tona profesionale i shfaqen qëndrimet. Ka qenë një takim me një pajtueshmëri dhe bashkëpunim shumë të thellë, është takimi me një pajtueshmërinë më të madhe, virtualisht 100 për qind jemi pajtuar për masat që do t'i marrim. Janë trajtuar dhjetë tema thelbësore të arsimit dhe shëndetësisë për të cilat jemi pajtuar. Në takimin e pestë kemi pasur pajtueshmëri më të madhe", ka thënë Konjufca.



Oda Amerikane takon senatorët dhe kongresmenët amerikanë

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Thellimi i bashkëpunimit ekonomik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe rritja e investimeve amerikane në Kosovë janë kyçe për stabilitetin e tërë rajonit. Ky ishte konkluzioni kryesor nga takimet e Bordit të Guvernatorëve të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, me anëtarë të Kongresit dhe Senatit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Uashington.

Në takime të ndara me dhjetë ligjvënës amerikanë, lidhshipi i Odës Amerikane ka prezantuar

zhvillimet e shumta në Kosovë. Mes të tjerash, në këto takime është diskutuar edhe për promovimin më të madh të potencialeve ekonomike të Kosovës nga ana e ligjvënësve amerikanë dhe për organizimin e mundshëm nga ana e tyre të delegacioneve tregtare në Kosovë.

Gjatë dy ditëve delegacioni i Odës Amerikane ka takuar kongresmenët Eliot Engel, Michael Guest, Dean Philips, Bill Flores, David Price (kryesues i Partneritetit Demokratik të Kongresit), Mark

Wayne Mullin, Adrian Smith, Mike Conaway dhe Tim Burchett.

Takim shumë i rëndësishëm ishte ai me senatorin nga Shteti i Aiovas, Charles Grassley, kryesues i Komitetit për Financa të Senatit Amerikan, komitet ky i cili mbulon fushën e tregtisë dhe të tatimeve. Anëtarët e Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane kanë diskutuar edhe për nevojën e vazhimit të statusit të Sistemit të Përgjithësuar të Preferencave (GSP) për Kosovën, i cili aktualisht u mundëson kom-

panive prodhuese nga Kosova eksportimin pa doganë të mbi 3 500 produkteve në ShBA, por edhe zgjerimin e listës me produkte të tjera.

Delegacioni i Odës Amerikane është pritur edhe në Departamentin e Shtetit, në Zyrën e Çështjeve të Evropës Juglindore, ku është diskutuar për nevojën që Kosova të demonstrojë stabilitet politik, t'i vazhdojë reformat për përmirësimin e mjedisit afarist dhe ta promovojë tregtinë e lirë. Mundësitë e reja të financimit për

kompanitë kosovare, pas krijimit të Korporatës Financiare Zhvillimore (DFC), janë diskutuar në takim me zyrtarët e Korporatës së Investimeve Private Tejoqeanike (OPIC). Pas Uashingtonit, lidhshipi i Odës Ekonomike Amerikane do të udhëtojë për në shtetin amerikan të Minnesotas, për të diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit ekonomik me këtë shtet, në të cilin një numër i madh i kompanive nga lista "Fortune 500" e kanë selinë e tyre.



KEDS-i vendos tetë trafo të reja në Klinë të Skenderajt

SKENDERAJ, 4 NËNTOR (ER) - KEDS-i ka përfunduar një projekt të madh investues në Klinën e Epërme, të Mesme dhe Klinën e Ulët të Skenderajt. Ky investim kap një kosto afër gjysmë milioni euro. Fshati, i ndarë në tri pjesë, ka një shtrirje të hapur dhe shtëpitë janë larg njëra-tjetrës. Ekipet e KEDS-it në fshat kanë energjizuar tetë trafo të reja, investim i kompanisë, si dhe kanë rikonstruktuar një trafo ekzistuese.

Gjithashtu, gjatë punimeve ekipet e KEDS-it kanë vendosur

400 shtylla betoni të tensionit të ulët dhe afër 50 shtylla të tensionit të mesëm dhe kanë shtrirë kablo nëntokësore dhe ajrore të tensionit të ulët dhe të mesëm.

Në Klinë të Mesme KEDS-i ka ndërtuar tri trafo të reja me kapacitet 250kVA dhe dy të tjera me fuqi 160kVA dhe një trafo me fuqi 250kVA është rikonstruktuar.

Në Klinë të Epërme ka vendosur një trafo me fuqi 100 kVA, ndërsa në Klinë të Ulët është rikonstruktuar një trafo me kapacitet 630kVA. Kjo ka mundësuar që në

fshat të përmirësohet dukshëm gjendja energjetike për këta banorë, të cilët deri tani kanë pasur probleme të mëdha me rrymë. Tani 500 konsumatorë të kësaj ane do të kenë furnizim stabil dhe energji kualitative.

Banori Halil Hasani nga Klina e Mesme ka falënderuar ekipet e KEDS-it për këto ndryshime në fshatin e tij. "Investimi në fshat ka qenë më se i domosdoshëm. Mund të them se tash 100 për qind rryma është ashtu siç duhet. Tash çdo lagje e ka trafon e vet", ka thënë Hasani.



KMDLNj-ja e kundërshton vendimin e BQK-së për rishikimin e tarifave për sigurim të veturave

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) e kundërshton rritjen e taksës për sigurim të automjeteve nga kompanitë e sigurimeve. Sipas KMDLNj-së, përgjegjëse kryesore është Banka Qendrore e Kosovës (BQK), e cila, në vend se ta luajë rolin e rregullatores së këtyre kompanive, po bëhet pjesë e zhvatjes aktive të buxhetit të qytetarëve të Kosovës

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) e kundërshton rritjen e taksës për sigurim të automjeteve nga kompanitë e sigurimeve. Për këtë KMDLNj-ja e ka bërë përgjegjëse kryesore Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), e cila, në vend se ta luajë rolin e rregullatores së këtyre kompanive, po bëhet pjesë e zhvatjes aktive të buxhetit të qytetarëve të Kosovës. "Kompanitë e Sigurimeve të Kosovës kërkuar nga BQK-ja t'u lejohet rritje prej 36.5 përqindësh për sigurimin e automjeteve,

kurse BQK-ja u tregua më 'dorështrënguar' ndaj tyre dhe më 'bujare' ndaj qytetarëve, duke e lejuar rritjen prej 21.5 përqindësh për sigurimin e automjeteve e që është në kundërshtim të plotë me mundësitë financiare të qytetarëve sikur që kjo është shumë më e lartë se inflacioni zyrtar në Kosovë. Që nga përfundimi i luftës kompanitë e sigurimeve në Kosovë kanë caktuar tarifën e sigurimeve duke pasur parasysh interesin dhe përfitimet e atyre që kanë drejtuar kompanitë, e të cilët kanë qenë instrument ekzekutiv i politikanëve të kriminalizuar të cilët kanë menaxhuar këtë strukturë përmes famil-

jarëve të tyre apo ndikimit politik. Për vite të tëra, vazhdon edhe tani, që bashkatdhetarët nga diaspora janë detyruar ta paguanin 'haraçin' gjatë hyrjeve në Kosovë me arsyetimin se, meqë Kosova nuk është pjesë e Kartanit të Gjellbër, janë të detyruar të zbatojnë këtë pagesë krejtësisht diskriminuese e që nuk bëhet në vendet e tjera", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas këtij institucioni, Byroja e Sigurimeve e Kosovës është arsyetuar se në Kosovë qarkullojnë mbi 100 000 automjete të peregjistruara dhe të pasiguruara, prandaj edhe ndahen me humbje, në ndërkohë që pagat e tyre nuk dallojnë aspak nga kolegët e tyre në vendet më të zhvilluara të botës. "Qarkullimi i mbi 100 000 automjeteve të pasiguruara dhe të peregjistruara, sipas Byrosë së Sigurimeve të Kosovës, paraqet edhe një rëndësishme pengesë kryesore që Kosova nuk qenka pjesë e Kartanit të Gjellbër, ndërkohë që në këto bisedime Kosova është përfaqësuar nga niveli më i ulët profesional i cili nuk ka përfaqë-

suar interesin e qytetarit, pos interesin personal dhe të politikës. Byronë e Sigurimeve të Kosovës gjatë tërë kohës e kanë përcjellë afërsisht korruptive dhe keqmenaxhim financiar, ndërkohë që asnjëherë nuk ka arritur të ndërtojë dhe stabilizojë një piramidë menaxhuese, profesionale dhe të qëndrueshme", thuhet në këtë reagim. Sipas KMDLNj-së, qytetarët e Kosovës, pagues të rregullt të sigurimeve për veturat e tyre, nuk mund dhe nuk duhet të penalizohen duke u mbuluar humbjet kompanive të sigurimeve shkaku i 100 000 veturave të pasiguruara dhe të peregjistruara si dhe menaxhimit të keq të tyre. "Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prishtinë e kundërshton rritjen e taksës për sigurim të automjeteve nga kompanitë e sigurimeve dhe përgjegjës kryesor për këtë e bën BQK-në e cila, në vend se ta luajë rolin e rregullatorit të këtyre kompanive, po bëhet pjesë e zhvatjes aktive të buxhetit të qytetarëve të Kosovës. Në shumë vende të botës, nëse i keni dy vetura dhe

të cilat nuk i përdorni çdo ditë, me një palë tabela mund t'i ngjini veturat duke i zhvendosur sipas nevojës, nga njëra veturë në tjetrën. KMDLNj-ja mendon se pikërisht ulja e çmimeve tarifore për sigurim dhe regjistrim të automjeteve mund të ndikojë shumë në zvogëlimin e numrit të 100 000 veturave të pasiguruara dhe të peregjistruara. Rritja e paralajmëruar e tarifave nga kompanitë e sigurimeve, me pëlqimin diskriminues të BQK-së, vetëm sa do ta rrisë numrin prej 100 000 automjeteve të pasiguruara dhe të peregjistruara", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Në këtë reagim është thënë se mosrenditja e bashkëpunimit midis Byrosë së Sigurimeve të Kosovës dhe Policisë së Kosovës gjithashtu ndikon në rritjen e numrit të automjeteve të pasiguruara dhe të peregjistruara si dhe e betonon ndarjen thuaja legale në përqindje të tregut të kompanive të sigurimeve që pastaj e kanë lehtë të manipulojnë me tarifa dhe çmime, gjithmonë në dëm të interesit të qytetarit të Kosovës si dhe diasporës.



Përfundon trajnimi "Eksporti dhe promovimi ndërkombëtar"

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), në kuadër të projektit "Nxitja e transformimit digjital të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë", ka organizuar trajnimin me temën "Eksporti dhe


promovimi ndërkombëtar". Trajnimi kishte në fokus tema konkrete për të gjitha kompanitë nga sektorë të ndryshëm që aktualisht janë eksportues apo synojnë tregun ndërkombëtar. "Objektivat kryesore të trajnim-

it ishin zhvillimi i njohurive mbi temat, si: hulumtimi i tregut, çaja në treg të ri, forma e komunikimit, roli i panairëve dhe takimeve B2B, barrierat në eksport dhe aktorët që duhen angazhuar për eksport. Të

gjitha këto tema ishin me interes shumë të madh për pjesëmarrësit, pasi që deri më tani ka munguar një informacion i gjerë mbi këto tema", është bërë me dije në njoftimin e OEK-ut.



Zvarritjet paarsyeshmërisht të arsyetuara të formimit të institucioneve nga LV-ja dhe LDK-ja



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Dashuri pa pasion, marrëdhënie pa ereksion: Po bëhet thuaja një muaj kur zgjedhjet e përgjithshme, të parakohshme, përfunduan e që tani, pas numërimeve dhe rinumërimeve, ankesave dhe parashtrësive, e kemi një pasqyrë më të qartë, edhe të fituesve edhe të jofituesve. Këtë mozaik të rezultateve po e mjegullon koalicioni Nisma-AKR dhe PD duke krijuar një situatë ku ata deklarojnë se e kanë kaluar pragun, ndërkohë që rezultatet preliminare, e që duhet të certifikohen nga KQZ-ja, e thonë të kundërtën: ky koalicion mbetet jashtë Kuvendit të Kosovës duke marrë në thua pikërisht në këtë prag. Fitues i padiskutueshëm i këtyre zgjedhjeve është Albin Kurti, i shoqëruar nga LV-ja, pas së cilës vijnë LDK-ja, PDK-ja, AAK-ja dhe Lista Serbe e Aleksandar Vuçiqit në Kosovë. Koalicioni parazgjedhor midis LDK-së dhe LV-së dështoi për faktin se LDK-ja konsideronte se do të jetë e pakonkurrencë në këto zgjedhje, natyrisht si fitues, prandaj nuk pranonte kurrfarë marrëveshje me LV-në, ndonëse njëra-tjetër i shprehnin dashuri platonike, ekskluzivisht për përfitime të pushtetit dhe politike. Sondazhet para zgjedhjeve e nxirrnin LDK-në fituese me 6-7 për qind dallim prandaj, pse të bëjë koalicion parazgjedhore dhe të pranojë kushte kur, si "fitues", ju i përcaktoni rregullat e lojës! Nuk doli të jetë ashtu dhe, pavarësisht prej trendit që nuk linte asnjë hapësirë se kush është fitues i këtyre zgjedhjeve, LDK-ja po pret certifikimin e rezultateve nga KQZ-ja ndonëse e ka të qartë se sa iu përket rezultateve: "pordhi kali në derë të hanit...", prandaj nuk po ngutet për arritjen e një marrëveshjeje që duket të jetë e pashmangshme me LV-në. Nëse LV-ja dhe LDK-ja janë deklaruar për një koalicion apo "dashuri politike", nuk e kam të qartë pse tani vonohen për arritjen e kësaj marrëveshjeje?! Rezultati i zgjedhjeve nuk ka gjasa të ndryshojë në favor të LDK-së sikur që duket se koalicioni Nisma-AKR dhe PD nuk do të mund të përdoret nga LDK-ja

si kërcënim për disiplinim të LV-së, prandaj situata është shumë e qartë. Më herët, LV-ja dhe LDK-ja kanë qenë në luftë të hapur verbale dhe fizike të cilën, disa zëra oportunistë të LDK-së, e arsyetuan se ata që kanë ushtruar dhunë ndaj LDK-së nuk janë më pjesë e LV-së, por e PSD-së! Ky arsyetim e sjellë armëpushimin e nevojshëm dhe të domosdoshëm midis këtyre dy subjekteve që "duan" dhe duhet ta bëjnë koalicionin dhe, çdo zvarritje në këtë drejtim është e paarsyeshme, duke vonuar formimin e institucioneve. Këto dy subjekte politike do t'i kenë së paku 60 deputetë dhe me përkrahjen e pakicës joserbe mund të sigurojnë 70 vota, mjaftueshëm të bëjnë institucione më stabile se koalicioni paraprak. "Armiqësia" midis LV-së dhe LDK-së duhet të pushojë përkundër dallimeve të mëdha, jo vetëm programore. Në fund të fundit, këto parti kanë pasur dallime edhe para zgjedhjeve, por janë përcaktuar për një koalicion qeverisës, e që në rastin konkret duhet të vlerësohet si pozitive dhe standard i munguar, me asgjë nuk po pengohet nga opozita, PDK-ja dhe AAK-ja. Është krijuar një mit se pikërisht PDK-ja dhe AAK-ja e duan dështimin e marrëveshjes midis LV-së dhe LDK-së për të krijuar matematika të tjera qeverisëse e që mendoj se janë krejtësisht të pavërteta. Jam shumë i sigurt se në asnjë rrethanë PDK-ja nuk do të pranojë të bëhet pjesë e pushtetit sepse, me pranimin e shpejtë të rezultateve dhe deklarimin se kalon në opozitë, ka dërguar porosi të qarta se do të bëhen përpjekje për konsolidim të partisë, si opozitë konstruktive. Frika nga PDK-ja dhe AAK-ja është vetëm një arsyetim për mungesën e ereksionit qeverisës të një dashurie, pa pasion që ka qenë dhe mbetet ajo midis LV-së dhe LDK-së. LDK-ja, e mësuar se pavarësisht prej rezultateve të zgjedhjeve (nga viti 2004 kurrë nuk ka qenë fituese), gjithmonë është bërë pjesë e pushtetit duke e marrë postin e kryeministrit e që është menaxhuar nga PDK-ja. Në këtë kartë po luan edhe tani duke e injoruar faktin se Albin Kurti dhe LV-ja do ta kallin Bangladeshin dhe Nepalën e nuk do të lëshojnë pe për postin e kryeministrit. Dhe kanë plotësisht të drejtë! Të kota janë kërcënimet e Isa Mustafës se, ose do të "martohen" me LV-në, ose "virgjërinë e shkërdhyer shumë herë më parë" nuk do t'ia japin askujt tjetër, por se do të shkojnë në zgjedhje të reja apo do të kalojnë në opozitë sikur që bënte dikur Penelopa, gruaja e Odiseut,

që trillonte njëqind mijë arsye për t'i refuzuar shkuesit apo hamshorët që donin t'i hipnin, jo se ishte shumë e bukur, por se ishte gruaja e Odiseut! LDK-ja, nëse nuk "martohet" me LV-në, nuk ka alternativë tjetër përveç Kadriut dhe Ramushit. Do të bëhej pjesë e një tresheje ku do të dhunohej pamëshirshëm. Është një e keqe me të cilën po përballlet thuaja e gjithë LDK-ja; nuk duan ta pranojnë të vërtetën se Albin Kurti e ka fituar të drejtën e votës të bëhet kryeministër i Kosovës dhe "partneritetin" me LV-në, nuk po e marrin si përparësi dhe detyrim të përmbushjes së premtimeve elektorale, por se po e përjetojnë si një dhunë që mund të zgjasë një mandat të plotë apo një pjesë të këtij mandati. Nëse Franca dhe Gjermania e kanë tejkaluar armiqësinë shekullore duke e shndërruar në miqësi dhe bashkëpunim, nuk ka asnjë arsye që kështu të mos veprojnë LV-ja dhe LDK-ja. Kam përshtypjen se në këtë situatë LV-ja po duket më pajtuese, kurse LDK-ja po tregohet më rigjide. Së paku nëse iu referohemi zyrtarëve të lartë të këtyre dy subjekteve politike. Nëse është kjo që po duket dhe po dëgjohet, LV-ja e ka të padiskutueshëm vetëm postin e kryeministrit, kurse LDK-ja edhe këtë post po e konsideron si të negociueshëm! Pse po ndodhë kështu: Isa Mustafa e ka menaxhuar me një saktësi mahnitëse mundësinë e rifaktorizuar në skenën politike. Po të mos ishin të theksuara kundërshtimet e mëdha brenda LDK-së, sot kjo parti do të ishte fituese e zgjedhjeve. Me fëmijë të lazdruar, asnjë prind nuk mund të ndihet rehat por, edhe LDK-ja, si çdo prind i papërgjegjshëm, është munduar t'i mbulojë dhe arsyetojë çarjet e thella brenda partisë. Po të mos ishte Isa Mustafa, LDK-ja do të ishte duke luftuar për vend të tretë, me AAK-në. Kjo është gjendja momentale. Çka do të bëhet në të ardhmen me LDK-në, mbetet të bëhet një analizë për të cilën unë nuk kam kapacitet të duhur. Isa Mustafa i pajtoi të gjithë, dikë në listë për deputet, tjetrin kandidat për ndonjë post kryeministral apo ministral dhe shumë premtime të tjera në këtë bingo të paskrupullit politike. Tash, Isa Mustafa, në vend se të pajtohet me gjendjen reale dhe të bëjë përpjekje që sa më parë të formohen institucionet, duke lëshuar në ajër balona provues dhe kondomë me afat të skaduar politikë, po e teston reagimin e LV-së. Vetëm në monarki janë të trashëguara postet dhe kursesi

në shtetet dhe vendet demokratike. Duket se Kosova, ndonëse e deklaruar si Republikë Parlamentare, në sjelljet dhe veprimin praktik ka elemente të trashëgimisë jomorale dhe të pamerituar. Mbahet mend parapagimi i Enverit për post të ministrit për punë të jashtme që edhe e realizoi. Apo planifikimi i Hashim Thaçit-Shimës për postin e presidentit e që e realizoi pikërisht në sajë të përkrahjes së LDK-së dhe disa mercenarëve që fituan poste ambasadorësh apo favore në biznes. Tash Isa Mustafa po e vlerëson se posti i presidentit qenka mënyra më e mirë për përmbyllje të karrierës politike, me shumë rënie dhe ngritje. Menjëherë pas kësaj doli Luta duke thënë se si nuk na është kujtuar se ky post është i bekuar për Isa Mustafën. Kështu deklaruan edhe disa ballonë të tjerë të blerë në shitoret; gjithçka 0.1 cent aq sa është edhe vlera e tyre reale. LDK-ja duhet ta urojë LV-në dhe Albin Kurtin për fitore dhe postin e kryeministrit dhe me urgjencë të bëjnë marrëveshje politike për formim të institucioneve. Përralla janë zgjedhjet e reja dhe qëndrimi në opozitë; as nuk e do LDK-ja e as nuk e lejojnë "miqtë" ndërkombëtarë! LDK-ja, duke përdorur taktikat e vjetra, është fisnikëruar edhe me "përkrahje" të reja nga "miqtë" ndërkombëtarë. LDK-ja po luan në kartën se LV-ja, duke pasur qëndrim të fortë rreth bisedimeve me Serbinë, do të hasë në mllëfin e ndërkombëtarëve ndaj Albinit e që do të ndikojë që LDK-ja të eklipsohet si bashkëpunëtor i pazëvendësueshëm. Dhe besoj se nëse luan në këtë kartë, do të digjet shumë, derisa të bëhet shkumb e hi. Nuk ka asnjë dyshim se edhe LV-ja sikur edhe Albini do ta kalojnë me sukses procesin e zbutjes sepse janë të vetëdijshëm për pasojat prandaj, në këto rrethana të reja, LDK-ja duhet të jetë partnere e LV-së jo për ta realizuar 100-përqindëshin e bisedimeve, por për t'i bërë më të vogla dhe më të menaxhueshme dëmet që i janë bërë më herët Kosovës e që iu ka rënë në hise të nënshkruajnë Albini dhe Isaja. Po si duhet të veprojnë opozita: Ramush Haradinaj bëri mirë që hoqi dorë nga posti i deputetit sepse në këtë mënyrë do të ketë më shumë kohë të merret me partinë. Realisht AAK-ja më ka zhgënjyer me numrin e votave aq më parë që u bashkëdyzua me PSD-në. PSD-ja mbeti parti që menaxhon kryeqytetin e Kosovës, Hiroshimën, të cilën skajshmërisht e ka shëmtuar duke e shpërfytyruar hajnisht

nga identiteti i saj. Po duket se ky do të jetë veprimi i fundit që e bëjnë, së bashku me oligarkët mafiozë të ndërtimit. Nuk mund të gjeni sot asnjë rrugë të Prishtinës e që nuk është e dëmtuar nga kamionët e shumtë që 24 orë bartin materiale inerte nga lokacionet që i kanë shndërruar në varreza kolektive arkitektonike. Më shumë takoni autobote me betone në rrugët e Prishtinës se vetura të Policisë së Kosovës apo ato të ndihmës së parë. Tmerr i papërkrahur, në rrugët e Prishtinës. Ramush Haradinaj dhe AAK-ja duhet ta përkrahin formimin e qeverisë dhe nuk duhet të lejojnë që Lista Serbe ta ketë votën përcaktuese për Kosovën dhe proceset politike. Edhe Kadri Veseli veprimin më të mirë do ta bënte nëse largohet nga posti i deputetit dhe të merret me reformimin e partisë, me një kusht, nëse i mbijeton vullnetit të Samiut që po e kërkon kokën politike të Kadrisë. Nuk është aspak e pëlqyeshme që nga posti i kryetarit të Kuvendit të bëheni deputet. Këtë e pati provuar edhe Jakup Krasniqi, por se më vonë u përcaktua për postin e që e kishte, me të gjitha përfitimet që i takojnë dhe pa asnjë përgjegjësi reale. Kadri Veseli, pavarësisht se çfarë programi do të ketë koalicioni LV-LDK, pa asnjë kusht duhet ta votojë këtë qeveri, si veprim teknik, duke mos u dëgjuar fare për 100 ditët e para të qeverisjes. Pastaj duhet ta luajë rolin e opozitës, pa asnjë dyshim asaj konstruktive. PDK-ja dhe AAK-ja kanë detyrim moral të jenë konstruktive sepse edhe vetë kanë kontribuar në këtë gjendje që e kemi sot. Madje, përgjegjësia e të gjithë aktorëve, hiç këtu LV-në, është tepër e madhe për t'u tërhequr nën mrip! Edhe nëse nuk pranojnë do të detyrohen të pranojnë! E mira e së mirës është që të bashkëpunojnë në mënyrë që dëmet të jenë sa më të vogla. Jam shumë kureshtar të shoh nëse opozita do ta votojë qeverinë Kurti e që do të ishte edhe një standard demokratik, në të kundërtën do të jenë në kundërshtim me veprimet që i morën menjëherë pasi përfunduan zgjedhjet. Sa mund të realizohen pritjet: Po të mos ishin bisedimet me Serbinë prioritet dhe kusht i caktuar nga ndërkombëtarët, gjërat do të shkonin më mirë. Kosova ka buxhet social dhe çdo ndihmë materiale nga jashtë do të kushtëzohej me dëgjueshmëri politike. Ky do të jetë pragu i Nismës për LV-në e cila do ta kushtëzojë jetëgjatësinë në

skënë politike kosovare. Bisedimet me Serbinë do të jenë parakushte për të gjitha proceset e tjera, me gjasë do ta prodhojnë efektin domino. Prandaj, shumë votues edhe mund të zhgënjehen për shkak të mospërbushjes së premtimeve elektorale. Aktualisht, në pozitën më të rëndë është Albin Kurti, i mbërthyer midis Skilës (premtimeve të dhëna dhe qëndrimit të fortë) dhe të Haridbes (kërcënimeve të ndërkombehtarëve dhe mundësisë reale për implementim të këtyre kërcënimeve). Albin Kurti do të kryqëzohet sikur Krishti në rrugën e tij të gjatë të Golgotës, deri në përfundim të arritjes së një marrëveshjeje me Serbinë. A do t'i mbijetojë kësaj Golgote, nuk jam aspak i sigurt! Mirëpo, në variantin më të keq, më mirë është t'ju kryqëzojnë të tjerët se ta kryqëzojë veten! Serbia, e ndihmuar nga ndërkombehtarët dhe një grusht i politikanëve kosovarë, rëndë e ka dëmtuar dhe po e dëmtton Kosovën duke imponuar një marrëveshje të dëmshme. Kjo është ajo që mund t'i presë këmbët e veprimt, edhe Albinin, por edhe koalicionit qeverisës, prandaj edhe pritjet e mia janë të vogla. Nëse gaboj në këtë parashikim, do të bëhet mirë për Kosovën dhe shumë kam dëshirë të gaboj në këtë rast. Mirëpo shenjat janë ndryshe, po luhet një lojë e ndyrë, ku askush nuk do të mbetet i papërlyer; sikur ata që i kanë krijuar kushtet e shpërthimit të kanalizimit, me ndyrësira, ashtu edhe ne që për interesa të ndryshme kanalizimin e kemi pranuar si të ishte Drini i Bardhë. Gjithmonë na kanë mashtruar: bëjeni këtë do t'i keni vizat. E bëmë, por na treguan bërrylin. Nuk e kam të qartë pse ne duhet t'i besojmë presidentit Trump në kohën kur më shumë se 60 për qind e amerikanëve nuk i besojnë. Duhet të mos i gënjejmë të tjerët pasi e kemi gënjyer veten se jemi më amerikanë se vet amerikanët. Kurrë nuk mund të bëhemi të tillë, me gjithë servilizmin antologjik mashtrues që e kemi. Sa më shumë të servilohe mi aq më pak do të na besojnë. Kosova duhet të bisedojë me Serbinë vetëm duke mbrojtur dhe kërkuar respektimin e integritetit territorial, sovranitetit shtetëror brenda këtij integriteti, respektimit të fqinjësisë së mirë dhe eliminimit të pretendimeve territoriale. Këto janë parimet bazë që duhet të jenë të panegociueshme kurse, për të gjitha të tjerat duhet të bisedohet. Deri atëherë IV-ja duhet të heqë dorë nga e "drejta e Sheriatit" duke bërë ankesë për çdo votë të panumëruar sikur edhe që Luta duhet, më shumë të dëgjojë muzikë qetësuese e jo të shpërndajë kakofoni të tipit "edhe po ma kona, edhe nuk po më lenë nana". Formoni institucionet dhe bashkërisht ndërtojeni murin mbrojtës apo Linjën Mazhino!

Në Prishtinë hapet qendra e qëndrimit ditor për fëmijë në situatë rruge

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me organizatën Terre des hommes - Kosovo (Tdh), ka hapur qendrën e qëndrimit ditor për fëmijë në situatë rruge. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se kjo qendër, e para e këtij lloji, është bazuar në modelin e shërbimeve të specializuara për fëmijët në situatë rruge, shërbimet për fëmijë që kanë nevojë për mbrojtje si dhe shërbimet e specializuara për fëmijët viktime të abuzimit seksual, të zhvilluar enkas për Kosovë nga Tdh. "Qendra përmes ofrimit të shër-


bimeve të integruara do të kontribuojë në mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve duke zvogëluar kohën që ata kalojnë në rrugë, drejtpërdrejt duke minimizuar kështu rreziqet e mundshme që u kanosen atyre për shkak të qëndrimit të gjatë në rrugë. Qendra ditore do të ofrojë një ambient të ngrohtë ku këta fëmijë do të ndihen të sigurt, do ta kenë mundësinë të integrohen, përdërisa në shërbime gjithashtu përfshihen shujtat ushqimore, lojërat edukative, socializimi e aktivitetet arsimore, si dhe këshillimi profesional", ka thënë Ahmeti.



Pas Prishtinës, edhe Obiliqi do të bëhet me ekran për kontrollin e cilësisë së ajrit

Obiliq, 4 nëntor (ER) - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka pritur në takim përfaqësuesit e kompanisë JICA si dhe përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në këtë takim nga ekspertët e JICA-së u prezantua projekti i zhvillimit të kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës, me ç'rast u diskutua edhe për vendosjen e ekranit në qendër të Obiliqit i cili do ta bëjë kontrollin e cilësisë së ajrit.

Kryetari Gashi i ka njoftuar përfaqësuesit ndërkombehtarë për projektet që po zhvillohen në Komunën e Obiliqit, për sfidat e komunës në aspektin e ndotjes, për përgjegjësinë nga ana e KEK-ut, për mosrespektimin e Ligjit për Obiliqin. Gjithashtu, ka falënderuar ekspertët e JICA-së për kontributin e tyre në aspektin e mbrojtjes së mjedisit, në të njëjtën kohë ka mirëpritur projektin e vendosjes së ekranit në qendër të qytetit i cili do ta bëjë kontrollin e cilësisë së ajrit.



Administrata e Malishevës e përgatitur mirë për ofrimin e shërbimeve komunale

MALISHEVË, 4 NËNTOR (ER) - Të hënën është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve në Komunën e Malishevës, e cila është drejtuar nga kryetari i komunës, Ragip Begaj. Në këtë mbledhje drejtorët e drejtorive komunale kanë raportuar për aktivitetet e drejtorive për javën e kaluar si dhe për planifikimet për javët në vijim. Gjatë raportimeve të tyre, shefi i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, Agim Morina, ka bërë me dije se të gjitha shërbimet në administratën komunale janë duke u kryer pa probleme, pa vonesa dhe shërbimet janë cilë-

sore. Morina, gjithashtu, ka treguar se drejtoria është e përgatitur mirë edhe për fundvit, kur edhe kërkesat për shërbime janë më të shumta për shkak të ardhjes së mërgimtarëve për festat e fundit dhe nuk parashihet të ketë probleme për ofrimin e shërbimeve të shpejta dhe cilësore. Edhe drejtoritë e tjera kanë raportuar për aktivitetet e tyre dhe për kryerjen e obligimeve dhe realizimin e planifikimeve të tyre. Në këtë mbledhje u bë e ditur se janë duke vazhduar realizimin e projekteve në rrugë, zgjerime të rrjeteve të kanalizimeve dhe projekte të tjera.



Muharremaj kërkon angazhim nga drejtorët komunalë për kryerjen e detyrave

Suharekë, 4 nëntor (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka mbajtur të hënën takimin e radhës me këshillin e drejtorëve komunalë, në të cilin është folur për punët dhe aktivitetet e të gjitha drejtorive,

me theks të veçantë për projektet që janë para përfundimit. Kryetari Muharremaj ka dhënë edhe obligime për drejtorët që do t'i kryejnë gjatë kësaj jave dhe ka kërkuar që të gjithë të jenë në shërbim të qytetarëve.



Ideale të Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut ishin liria, republika dhe bashkimi

Sabri KIÇMARI

*I dashur Baca Osman dhe Nëna Qamile,
Të dashur vëllezër dhe motra të Afrimit dhe Fahriut,
Shoqe dhe shokë,
bashkëveprimtare,
bashkëveprimtarë dhe miq të heronjve të kombit,
Të dashur pjesëtarë të familjeve të dëshmorëve, veteranë dhe invalidë të luftës,*

Më lejoni që sot, në 30-vjetorin e rënies së heronjve dhe shokëve tanë të dashur, t'i shmangem klisheës së fjalimeve tona përkujtimore. Nuk e di nëse kjo është një thyerje e protokollit të pashkruar, apo një sjellje tejshoqërore, por dua që ta kthej në vëmendjen tuaj një moment reflektimi për jetën dhe lirinë, shtetin dhe shoqërinë, Republikën dhe Shqipërinë.

Cili ka qenë mendimi i fundit politik e filozofik i Afrim Zhitisë para se të pushonte zemra e tij e madhe?

Cili ka qenë veprimi dhe reflektimi i fundit i Fahri Fazliut para se të shtrihej i goditur nga plumbat trupi i tij i pashëm?

Si një nga shokët e shumtë të tyre, një hamendësim i tillë më përcjellë prej 30 vjetësh. Do të dëshiroja shumë të dija për çastet e tyre të fundit: mendimet e tyre të fundit, reflektimet e tyre, veprimet e tyre të fundit.

Por, në të njëjtën kohë, e ndiej veten me fat, se e di cili ka qenë përfytyrimi i tyre për Lirinë, Republikën, Shoqërinë, Kosovën dhe Shqipërinë. I di shumë nga të fshehtat e panjohura publikisht, dashuritë dhe urrejtjet e tyre, miqësitë dhe armiqësitë, mallin, dhembjen dhe krenarinë e tyre. Nuk e fsheh: bashkëjetoi shpesh me këto kujtime.

Të nderuar miq,

2 nëntori i vitit 1989 është një shembull tipik përfaqësues, se si një popull e krijon historinë, duke sakrifikuar jetën dy të rinj idealistë, dhe me këtë fillon të ndërtojë të ardhmen. Siguria, me të cilën Afrimi dhe Fahriu shkuan drejt vdekjes, është e rrallë, është heroizëm i veçantë.

Si mund të shpjegohet kjo gatishmëri për shkuarje drejt vdekjes në rrafshin filozofik-politik? Si mund të shpjegohet guximi i Afrimit dhe Fahriut për të sfiduar vdekjen? Si mund të shpjegohet vetëdija e tyre për të pranuar, në një moshë të tillë të re, natyrshëmërinë e vdekjes për liri?

Në përgjigje të këtyre pyetjeve, do të mundohem që sot, me rastin e 30-vjetorit të rënies së tyre, të reflektoj në akord me botëkuptimet tona të para 30 viteve.

Afrimi në rrafshin teorik ka mbrojtur pikëpamjen se qëllimi i

politikës është liria. Ajo në kohën tonë manifestohej në formën e kërkesës "Kosova Republikë!" si hap i parë, kurse bashkimi kombëtar ishte rrjedhim logjik, ose qëllimi strategjik. Duke e njohur sentencën se "historia botërore është një përparim në vetëdijen e lirisë - një përparim që duhet ta njohim në domosdoshmërinë e tij", Afrimi ishte i vetëdijshëm se lufta për liri është e domosdoshme, sepse vetëm kur një komb është i lirë, ai mund të njohë dhe realizojë të vërtetën dhe jo thjesht të përmbush vullnetin e kombit tjetër. Ashtu siç është graviteti thelbi i materies, ashtu është edhe liria thelbi i frymës së kombit. Dhe, për të arritur lirinë, njeriu duhet të ngritet, të organizohet dhe të punoj kundër pushtimit, shtypjes dhe skllavërisë.

Fahriu ishte dora vepruese e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Ai ishte aksionisti, planifikuesi dhe realizuesi i planeve operative të sektorit të veçantë, i demonstrative dhe grevave. I vetëdijshëm se "njeriu lind i lirë, por gjendet gjithkrah i rrethuar nga prangat", Fahriu do të insistonte që qytetarët e Kosovës përmes veprimit konkret për idenë e lirisë të shndërroheshin në subjekt për vete. Duke u shndërruar nga subjekt në vete në subjekt për vete, ai e sfidon determinizmin fatalist të nomenklaturës së kohës, duke i dhënë kuptim lirisë si "liri e vullnetit, e lidhur menjë sferë të veçantë që e kishte parasysh njeriun e "përgjithshëm" veprues historik".

Të nderuar miq,

Kur e takova Afrimin për herë të parë në një banesë modeste studentësh, që ishte baza jonë e veprimtarisë në Breg të Diellit, në fjalitë e tij të para, njoha mendjen e thellë analitike politike dhe mendimin e ndritur shqiptar. E njoha njeriun e bashkimit. Atë ditë ne u bashkuam me një grup tjetër. Afrimi dhe unë ishim caktuar të përfaqësonim Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës në takim. Mendimi i tij racional, fjala e tij e peshuar dhe strategjia e tij afruese, i dhanë vullën idesë së bashkimit.

Në vitin 1988 pas arrestimeve dhe largimeve të shpeshta të shokëve të niveleve drejtuese të Lëvizjes Popullore të Kosovës, së bashku me Fadil Vatën dhe Beqir Beqën e konstituuam Komitetin Organizativ të Lëvizjes, si organ drejtues në nivel vendi, detyrë kjo e ngarkuar nga rrethet e ndryshme organizative. Kur më 27 shtator 1988 UDB na goditi keq, duke arrestuar rreth 44 shoqe dhe shokë të Lëvizjes Popullore të Kosovës (atëherë LPRK), shoku ynë i nderuar, që



për fat sot është në mesin tonë, Beqir Beqa u detyrua të largohej jashtë vendit. Vendin e tij në Sekretariatit e Komitetit Organizativ të Lëvizjes e zuri natyrshëm Afrim Zhitia. Ai mori përsipër organizimin e shtypit të fshehtë. Për tre muaj, u realizua ky synim yni: U botua fillimisht "Minatori" në ditët e Grevës së Urisë së Minatorëve, dhe më pas edhe "Rruga e lirisë". Në dy mbledhjet konsultative, të mbajtura në shkurt të vitit 1989, në familjen e Sahit Krasniqit në Obiliq, fjala e Afrim Zhitisë do të ishte e peshuar, orientuese dhe strategjike. Në tubimet solidarizuese me minatorët të studentëve, në demonstratën e 27 marsit dhe atë të 1 nëntorit 1989 Afrimi do të shkëlqente me fjalimet e tij, mendimet e tij dhe orientimet e tij prej drejtuesi. Në Konferencën e Lëvizjes në Divjakë më 22 prill 1989, Afrimi do të zbulonte para nesh gjithë potencialin e tij të dijes, maturimit politik dhe aftësisë strategjike. Më duhet ta them sot me mall dhe modesti njëkohësisht: U gëzova shumë që në përfundim të Konferencës do të bëja dorëzimin e detyrës së Sekretarit Organizativ të heroi ynë Afrim Zhitia, pasi që për mua u vendos të largohesha jashtë vendit. Dorëzimi i lidhjeve, informatave dhe planeve organizative të Afrimi është një nga momentet më të paharruara për mua. Fahriu operonte në një dimension tjetër veprues: siguronte burimet e armatimit, teknikën dhe veprimet operative. Ai ishte në ballë të demonstratës si njeri operativ, që jep orientimet, vendos për sulmet dhe tërheqjet. Ishte i dashur dhe i papërtueshëm. Kishte pushtuar zemrat e shokëve, që e njihnin, me dashurinë dhe vendosmërinë e tij. Kur e takova për

herë të fundit, ishte plot humor. Ishte nata ime e fundit në Kosovë, në banesën e tij, para se të largohesha. Në tavolinë mbante librin e Qemal Stafës. Një libër i fotokopjuar. Ndoshta kishte një lloj parandjenje: Fahriu ynë, bashkë me Afrimin, do të përsëritnin heroizmin e Qemal Stafës.

Të dashur miq,

Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu me punën dhe rënien e tyre kanë krijuar një atmosferë për-bashkësie morali për një ideal. Ideal i tyre ishte Liria, Republika dhe Bashkimi. Ata e njëjtësuan veten me kombin. Në këtë kontekst Afrimi dhe Fahriu kanë vdekur të lirë. Në vetëdijen dhe ndërgjegjen e tyre ata kanë qenë njerëz të lirë. Duke e sfiduar vdekjen me vetëdije të plotë, ata e kanë përcaktuar statusin e tyre vetërealizues në lirinë e kombit. Përmes kësaj sakrifike sublime, ata e përcaktuan edhe fatin e kombit të tyre. E motivuar prej tyre shoqëria shqiptare në Kosovë e realizon nivelin më të lartë të organizimit të bashkësisë së saj - organizimin e luftës çlirimtare, përmes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, bashkë me Fadil Vatën, Ali Ajetin dhe një gjeneratë të tërë veprimtarësh është viteve 1988-1989 simbolizojnë mendjet sakrifikuese ndër shqiptarë, të cilët në pushtetin e Republikës së ardhme të Kosovës e shihnin jo një forcë shtypëse, por themelin e lirisë dhe dinjitetit të qytetarit shqiptar. Ata ishin krejtësisht të çiltër në bindjet dhe përfytyrimet e tyre. Ata i dhanë përmbajtje lirie frymës politike, në formën e shtetit kombëtar. Ata ëndërronin një shtet të ri, i cili do të ishte më shumë se një kuadër ligjor të drejtash dhe obligimesh.

Ata ëndërronin një botë krejtësisht të barabartë, të lirë dhe të drejtë. Ata e donin shumë Shqipërinë dhe bashkimin kombëtar. Bota e tyre dhe shteti i tyre kishin natyrë ideale. Shenjtërimi i idesë së lirisë së kombit te ta ishte një lloj strehe për të shpëtuar shqiptarët nga vuajtjet, padrejtësitë dhe terrori i regjimit serb.

Të nderuar miq,

Për fund më lejoni të them diçka tepër personale. E kam ndjerë mungesën e tyre rregullisht, por veçanërisht në dy momente të rëndësishme të historisë sonë të re: - kam pasur shumë dëshirë që Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu të ishin në mesin tonë më 12 qershor 1999 - të përjetonin shporrjen e pushtuesve nga trojet tona dhe fitoren e UÇK. E di se do të dinin t'i gëzoheshin pa masë; - Dhe kam pasur ndjenja të përziera gëzimi e dhimbjeje njëkohësisht më 17 Shkurt 2008. Atë ditë më kanë munguar Ali Ajeti dhe Fadil Vata. Më kanë munguar Xhemajl Fetahaj dhe Fehmi Lladrovci me buzëqeshjen e tij të pakufishme dhe, zonja dhe zotrinjë, atë ditë më kanë munguar shumë Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu. Sa do të dëshiroja që Afrimi dhe Fahriu të ishin në mesin tonë dhe të përjetonin atë moment gëzimi për të gjithë ne. Por, unë them se ata janë emocionalisht në mesin tonë. Ata gjenden në frymën tonë lirisë. Ata janë pjesë e pandashme jo vetën e të kaluarës, por edhe e së tashmes, dhe në mënyrë të veçantë e së ardhmes sonë!

Lavdi ju qoftë!

(Fjalë e mbajtur në akademinë përkujtimore me rastin e 30-vjetorit të rënies së Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut).



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E rrallë

Amaneti i pazakontë, gruaja varroset në arkivol me logo çaji

Një grua në Britani e cila konsumonte 40 gota çaji në ditë është vendosur në një arkivol me logon e çajit të saj të pëlqyer. Mesatarisht ajo konsumonte një gotë në 24 minuta. 73-vjeçarja nga Leicesteri ndërroi jetë para dy ditësh, por ajo e kishte bërë të qartë amanetin. Ajo i kishte



kërkuar vajzës që ta vendoste në arkivolin me logon "Typhoon Box".

FOTO E DITES



Në Mexico City mbahet parada e Ditës së të Vdekurve. /AP/

E jashtëzakonshme

Zbulohet tuneli i fshehtë nën tualetin e banesës që të çonte në një fermë kanabisi

Një tunel i fshehtë që të çon në një fermë kanabisi është zbuluar në bazamentin e një teatri të vjetër në Londër. Tuneli 21 metra niste në tualetin e një shtëpie dhe vazhdonte poshtë një rrjeti dyqanesh që zëvendësuan teatrin në vitet



'60. Detektivët besojnë se fabrika e paligjshme mund të jetë në funksion për rreth 1 dekadë. Banda kriminale përdori kabllot nëntokësore për furnizimin me energji për t'i ngrohur bimët e kanabisit.

BARSOLETA E DITËS



- Sa është ora?
- 13:00.
- Po ti nuk paske. Si po e di?
- Përmes diellit.
- E natën qysh e di sa është ora.
- Dal dhe bërtas në mëhallë dhe del komshiu e thotë kush është ky budalla që u zgjua në 3:00 të mëngjesit.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.




DASHI

Sot doni ta ndryshoni rrugën që keni marrë për të tejkaluar një problem të caktuar. Duhet ta merrni edhe mendimin e të tjerëve.



DEMI

Keni kuptuar që jeta është e përbërë edhe nga gjëra të tjera përveç punës dhe po u dedikoheni këtyre gjërave tërësisht sot.



BINJAKËT

Iniciativat që do të ndërmerri sot do t'u japin shumë zgjidhje personale afër jush. Dikush do t'ju shprehë falënderimet në një mënyrë të ngrohtë.



GAFORRJA

Një problem konstant që nuk po ju lë të avanconi duhet ta zgjidhni nga rrënjët sepse do të vazhdojë t'ju torturojë për një kohë të gjatë.



LUANI

Sot keni vënë në dukje një anë të panjohur tuajën dhe mjaft të ndjeshme. Jeni kokëfortë në shumicën e rasteve dhe nuk i tregoni ndjenjat tuaja.



VI RGJËR ESHA

Dikush do të kërkojë sqarime nga ju se përse gjatë kësaj kohe nuk keni shfaqur përkushtimin e duhur.



PESHORJA

Këtë periudhë keni zgjedhur një mënyrë kontradiktore për të qenë në vëmendje, vetëm nëpërmjet heshtjes suaj dhe injorimit të personave të caktuar.



AKREPI

Keni bërë ç'është e mundur për t'i sqaruar gjërat me një person të caktuar, por përsëri ju kanë keqkuptuar.



SHIGJETARI

Sot mund t'ju lindin probleme me familjarët sepse nga punët e tepërta do të harroni disa ngjarje dhe situata që nuk mund të harrohen.



BRICJAPI

U keni dhënë hapësirë e duhur personave të duhur, por nuk jeni shprehur për këtë gjë. Do ta keni mirënjohjen e tyre në të ardhmen e afërt.



UJORI

Të ecni përpara në karrierën tuaj në këto çaste paraqitet mjaft e vështirë. Ka rrethana të caktuara që nuk ju lejojnë të bëni atë që doni.



PESHQIT

Kritikat e bëra ndaj jush po japin rezultate pozitive në punën tuaj sepse keni marrë më të mirën prej tyre dhe e keni vënë në zbatim.

Ajri i ndotur në Indi, Priyanka në xhirime me maskë



Aktorja Priyanka Chopra ka postuar një fotografi në "Instagram" ku shihet se ka vendosur një maskë përderisa po realizonte xhirimet në Nju Delhi. Kryeqyteti indian po përballlet me

ndotje të rëndë të ajrit e cila ka arritur në nivele të padurueshme. "Është kaq e vështirë për të xhiruar këtu tani sa që unë as nuk mund ta imagjinoj se si duhet të jetë të jetosh këtu në këto kushte", ka shkruar Chopra.

Cardi B shijon Disneylandin me të bijën



Ajo nuk heziton ta shfaqë shkëlqimin e saj si në kamera, po ashtu edhe në ngjarje të industrisë së profilit të lartë. Por kësaj here Cardi B zgjodhi një pamje të thjeshtë dhe rastësore në daljen e fundit.

Këngëtarja e dërgoi vajzën e vet Kulture, 15 muaj, në një udhëtim në Disneyland në Anaheim, California. 27-vjeçarja u shfaq pa make-up përderisa shijonte shëtitjen e mbushur me argëtim me vogëlushen e saj.



Dua Lipa me performancë që nuk harrohet në MTV EMA

Dua Lipa bëri një shfaqje për t'u mbajtur mend përderisa hapi ceremoninë e 26 të çmimeve MTV EMA, të mbajtur në Qendrën e Konferencave dhe Ekspozitës FIBES të dielën, me këngën e saj të re "Don't Start Now".

Këngëtarja 24-vjeçare siguroi që të gjithë sytë ishin tek ajo ndërsa ajo doli në skenë e veshur në të zeza duke shfaqur linjat dhe stilin e ri të flokëve. Krijuesja e hitit "One Kiss" u shoqërua nga disa valltare, bashkë me të cilat ofroi një performancë fantastike.

Kevin Hart: Jam i bekuar që jam gjallë



Komediani Kevin Hart është parë i shëndetshëm në këtë fundjavë vetëm disa javë pasi pësoi një aksident të tmerrshëm me makinë. "Unë jam duke u shëruar. Ndihej mirë. Jam i bekuar që jam gjallë", ka thënë Hart. Aktori i njohur kishte me vete qese me gjësende pasi doli

nga një qendër tregtare në Calabasas dhe u duk se po ecte mirë. Por, ai tha se duhet pak durim për ta parë atë sërish në komedi. "Duhet pak kohë. Tani jam duke pushuar, duke shijuar kohën me familjen dhe duke u shëruar. Kjo është ajo që ka rëndësi tani", ka deklaruar Hart.



Autor: GAZMEND MORINA		HEROI NË FOTO	KËNGËTARJA ZAHARIA	AKTORJA UELLSIANE NË FOTO ZETA JONES (shqip.)	ANNA VISSI	MENDJEH-OLLË	EPOKA E RE	PJESË E LIMANIT	FUSHËBE-TEJAT	BASHKËT.	PËRFYTYRIM IDEAL I SHOQËRISË NJERËZORE	RI FILLUAR
VEGËL DORE, QË PËRBËHET NGA NJË KOKË METALI							PESHUAR TEFIK (shk.)					
VINÇ										TITAN QYTET I MADH NË ITALI		
RITUAL					MJET KOMUNIKIMI LAGJE E MADH NË SHKUP							
PËLHURË QË SHTROHET MBI DYSHEK OSE QË I VIHET JORGANIT								DJALI I VAJZËS SHTET I VOGËL NË AMERIKË				
ZANORE			INSTITUTE AUDIO RESEARCH EMËR YNI FEMRE				KRYEQYTETI I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN DEM, TER (shq.)					
THIRRJA E MYEZINIT DY BASHKË-TINGËLLORE				MBRON DIÇKA NGA DIKUSH PJESË E SYRIT (sh.shq.)			AKTORJA E FAMSHME HUDSON (origj.) UNITED KINGDOM				ZANORE SHKENCËTAR	
EPOKA E RE		DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR	KËNGËTARJA SHQIPTARE MARKU	MUAJ I VITIT	EPOKA E RE	BASHKËT.	FUTBOLLISTI JOHN ... MIKEL (CHELSEA) FLORI	MINERAL ZAKONISHT PA NGJYRË, I FORTË DHE I PATRETSHËM ZANORË				SFOND SHKRONJASH
HAPËSIRË E MADHE UJI					PARADHËNIA ZACHARY ELEMENTARY LANE			E ZURA ME DORË		PJESË E VITIT (shq.) I LARMË		
LUFTËTARI GJERGJ ALIA					FUTBOLLISTI ANGLEZ UEJN BËRJE MË I RI			HOV, VRULLI FUTBOLLISTI KROAT KLASNIÇ			ELIZABETH TAYLOR KËNGËTARI GJEBREA	
KALORËS MESJETAR					LLOJ PJEPR I VERDHË (shq.) MODELJA ANGLEZE KATE ...					DITA E SHËNUAR NË KALENDAR ZANORË		
VEÇIMI					DËMTIM I NJË MAKINE GJATË KOHËS SË PUNËS FUTBOLLISTI FETAHU (shq.)					REOMIR, ALUMIN BASKETBOLL-ISTI EDMOND		
KAP DIÇKA TE PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDE				JO (ang.) SHKRIMTARJA KAMBERI	FAZA PUNËTORI I TEATRIT TË KUKULLAVE					PUBLICISTI SHQIPTAR NURELLARI MARKË E VESHJEVE SPORTIVE		
AZEM BEJTA			LLOJ VETURE JAPONEZE AKTORJA ANGLEZE HALL (shqip.)		FALJA FETARE QË BËJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT KRUIJA						BASHKËT. I ÇELIKOSUR	
THAHËM (bised.)					BESNIK (perkdh.) BASHKËT.			MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI	ZAKONI INATOSJE			BASHKIM I FORTË (shq.)
EPOKA E RE		TON, ERBIUM KAFSHË GJITARE BREJTËSË (shq.)			FEMËR E ZGJEDHUR BRUS ..		VËNIE E MINAVE LYMPHOEDEMA SUPPORT NETWORK				NË ÇFARË VENDI UJITA TOKËN	
I LËKU-NDSHËM NË QËNDRIME					KLUBI FUTBOLLI NË ITALI DY BASHKË-TINGËLLORE					KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT BASHKËT.		
ZANORË			DRAMË E SANTORIT PËRGËZIM				GRILLI KALLI MISRI QË VARET NË TRARËT E SHTËPISË PËR TU THARË				LETRARI PODRMIJA OTRANTO, PESCARA	
QYTET NË SHQIPËRI					KASOLLET E BARINJVE PËRËMËR PRONOR					SHIKOJ DIÇKA PËR NJË KOHË TË GJATË SHOK		
NJË PLANET (shq.)					OVEN VILSON INTER, LIVORNO		REGJISORI I FAMSHËM ... BURTON TITAN			GATESË E JONË TRADICIONALE SHKRONJA TË NJËJTA		
"RISANI"			PRINCIPATË ARABE ZANORË					BREJTËSI I VOGËL ZANORË			TREMB DIKË BASHKËT.	
GRIMCOVA (bised.)				SHTET I LASHTË NË EVROPË				PIRATI				

Nga 8-10 nëntor do të mbahet 'Fiction Fest'



Festivali i Prozës Artistike "FICTION FEST" me datat 08, 09 dhe 10 nëntor, 2019, e zhvillon edicionin e tij të dytë. Organizator kryesor i këtij festivali është Qendra për Kulturë dhe Edukim "SHESHI", ndërsa organizator ndihmës është "EUROPE HOUSE."

Dashamirësit e prozës artistike do të kenë rastin të takohen me këta shkrimtarë, që do të na nderojnë me pjesëmarrjen e tyre, e që janë: Roland Bartetzko (Gjermani), Agron Tufa

(Shqipëri), Roland Orçik (Hungari), Jurij Hudolin (Slloveni), Agron Y. Gashi (Kosovë), Rrahman Paçarizi (Kosovë), Erenestina Halili (Shqipëri), Ilire Zajmi (Kosovë), Jasna Dimitrijevic (Serbi), Albin Mehmeti (Kosovë), Shefqet Bylykbashi (Kosovë) dhe Elida Rrusta (Shqipëri). Shkrimtarët e mësipërm do të lexojnë pjesë të zgjedhura nga proza e tyre artistike, si dhe do të bashkëbisedojnë me të pranishmit lidhur me artin e tyre krijues dhe projektet e tyre

të ardhshme në fushën e prozës. Mbrëmja e parë dhe hapja e "FICTION FEST"- edicioni i dytë do të mbahet me datën 08 nëntor, 2019, ora 19:00, në ambientet e "EUROPE HOUSE", rr. UÇK, nr. 90, te Qafa, përballë Komunës së Prishtinës (ish-objekti i ProCredit Bankës). Në mbrëmjen e parë do të kemi rastin dhe kënaqësinë t'i takojmë dhe t'i dëgjojmë këta shkrimtarë: Roland Orçik, Rrahman Paçarizi, Erenestina Halili, Ilire Zajmi, Albin Mehmeti dhe Shefqet Bylykbashi.

Edicioni i dytë

SHESHI
QENDRA PËR KULTURË DHE EDUKIM

EUROPE HOUSE

FICTION FEST

FESTIVALI I PROZËS ARTISTIKE

08/11/2019 ORA:19:00 - 20:30	09/11/2019 ORA:19:00 - 20:30
Roland Orçik Rrahman Paçarizi Erenestina Halili Ilire Zajmi Albin Mehmeti Shefqet Bylykbashi	Roland Bartetzko Agron Tufa Jurij Hudolin Agron Y. Gashi Jasna Dimitrijevic Elida Rrusta

Vendi: Ambientet e EUROPE HOUSE, rr. UÇK, nr. 90, te Qafa përballë Komunës së Prishtinës (ish-objekti i ProCredit Bankës)

10/11/2019
ORA:12:00 - 13:00

Vizitë në Janjevë
Lexim i shkrimtarëve në shtëpinë
- muze të Shtjefën Gjeçovit, Janjevë
Vendi: Shtëpia-muze e Shtjefën Gjeçovit, Janjevë

Edicioni i dytë i "FICTION FEST" organizohet nga Qendra për Kulturë dhe Edukim "SHESHI"
Organizator ndihmës: EUROPE HOUSE

Edicioni i dytë i "FICTION FEST" u mbështet nga
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Drejtoria për Kulturë në Komunën e Prishtinës dhe Programi "Kultura për ndryshim", që financohet dhe menaxhohet nga Bashkimi Evropian, ndërsa implementohet nga Qendra Multimedia dhe Goethe Institute.

Partner kryesor medial i "FICTION FEST" është Gazeta online "INSAJDERI" in Insajderi
Ndërsa, partnerë mbështetës mediale janë portali për kulturë "ObserverKult" dhe revista për letërsi, kulturë, gjuhë, media "AKADEMIA" ObserverKult

Albanologu Mandala: E domosdoshme njohja e historisë së arbëreshëve

"Historia tregon që arbëreshët kanë qenë shumë më italianë se sa vetë italianët. Fakti që për shembull arbëreshët ishin në krye të lëvizjes që çoi Italinë të bashkohej në fund shekullin e XIX, tregon që tashmë ishin italianizuar. Ata ngulën këmbë që të krijonin një Itali të bashkuar", – thotë Mandala.

Albanologu i mirënjohur Matteo Mandala, në një intervistë tregon mbi studimet, historinë dhe integrimin e arbëreshëve në fundshekullin XV, të cilët ruajtën kulturën e tyre më së pari prej vetëdijes së tyre kombëtare, gjuhës e traditave dhe e zhvilluan edhe përtej kufijve, duke u bërë një shembull i suksesshëm i aftësisë bashkëpunuese, i dykulturës dhe i bashkëjetesës, jo vetëm për vendin, por për gjithë Europën.

"Historia tregon që arbëreshët kanë qenë shumë më italianë se sa vetë italianët. Fakti që për shembull arbëreshët ishin në

krye të lëvizjes që çoi Italinë të bashkohej në fund shekullin e XIX, tregon që tashmë ishin italianizuar. Ata ngulën këmbë që të krijonin një Itali të bashkuar", – thotë Mandala. Mandala e quan domosdoshmëri njohjen e historisë së arbëreshëve si një lidhje antropologjike, kulturore e gjuhësore me atë të shqiptarëve dhe përmend studiues arbëreshë të shekullit XVIII, si: At Gjergj Guxeta, Paola Maria Parrino, Nikol Keta, veprat e të cilëve, të një rëndësie të madhe historike, janë zbuluar, studiuar dhe synohet të botohen./atsh/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Topalli: Fitorja ndaj 'Niklit', motiv për derbin me Llapin

Ballkani i Ismet Munishit mori tri pikë ndaj Feronikelit në fundjavë. Të njëjtën gjë synon ta bëjë edhe nesër (e mërkurë) ndaj Llapit. Sulmuesi Jetmir Topalli nuk e për-mendi fitoren, por ka lënë të kuptohet se liderët e elitës kërkojnë maksimumin. Përkrahje maksimale nga tifozët ka kërkuar edhe klubi i Ballkanit, kurse Llapit i ka premtuar mikpritje në Suharekë



EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Skuadra e Ballkanit është duke e kryesuar IPKO Superligën e Kosovës në futboll me 29 pikë të grumbulluara. Kjo skuadër ka shkëlqyer në trembëdhjetë xhirot e para dhe me meritë të plotë është lidere, derisa në ndeshjen e fundjavës arriti të triumfojë ndaj kampionit në fuqi të Superligës, Feronikelit (0-2).

Sulmuesi Jetmir Topalli ka thënë të hënën për "Epokën e re" se për këtë ndeshje ishin përgatitur maksimalisht dhe me një angazhim nga të gjithë futbollistët është arritur fitorja. "Për fitoren ndaj Feronikelit ishim përgatitur maksimalisht dhe me angazhimin e pashoq të secilit prej lojtarëve arritëm të fitojmë", ka deklaruar Topalli.

Ballkani nga trembëdhjetë ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar nëntë fitore, dy barazime dhe dy humbje. Ndeshjen e radhës ky klub e zhvillon me Llapin e Tahir Batatinës, ku në ndeshjen e parë të zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Suharekë kishin luajtur baras 0-0.

Sulmuesi i talentuar, Jetmir Topalli, foli edhe për derbin ndaj Llapit, duke paralajmëruar se tri pikët e fituara në Drenas janë një motiv i madh për ndeshjen e radhës, e cila zhvillohet të mërkurën në Suharekë. "Fitorja ndaj Feronikelit na ndihmon dhe motivon edhe më shumë për ndeshjet që kanë mbetur në sezonin vjeshtor, përfshirë edhe derbin e radhës ndaj Llapit. Ne do të hyjmë në fushë të përgatitur maksimalisht dhe do të angazhohemi që t'i përmbushim detyrat e trajnerit Ismet Munishi, pastaj të shohim se çfarë do të ndodhë", ka thënë

Topalli.

Për derbin ndaj Llapit edhe klubi i Ballkanit nëpërmjet një shkrimi në faqen zyrtare në "Facebook" ka kërkuar përkrahje. "Klubi ka nevojë për përkrahje morale çdoherë, sidomos pas këtyre rezultateve pozitive. Edhe pse jemi lider në Superligë, tani kemi nevojë edhe më shumë për mbështetjen e publikut. Ju ftojme që edhe këtë herë t'i mbështesim me duartrokitje 'luanët' tanë. Ndihe mi krenar që vetëm pas vitit të dytë në elitën e futbollit kemi kthyer vëmendjen e gjithë Kosovës në Suharekë. Na pret një supersfidë me klubin me emër shumë të madh në Kosovë, Llapin, të cilin e mirëpresim në shtëpinë tonë", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ballkanit. Përderisa Ballkani pozicionohet në pozitën e parë, Llapi është në vendin e pestë me 23 pikë të grumbulluara.

SHKURT

Mumini, gjyqtar në FIBA Europe Cup

Gjyqtari i njohur i basketbollit, Xhelal Mumini, është nominuar për të gjykuar në ndeshjen Keravnos BC-Kapfenberg Bulls, në kuadër të xhiros së tretë në FIBA Europe Cup. Takimi do të zhvillohet më 6 nëntor në Nicosia të Qipros. Mumini ka gjykuar edhe në gara të tjera ndërkombëtare, kurse është i licencuar nga FIBA. Përveç tij, në këtë edicion edhe disa gjyqtarë të tjerë nga Kosova kanë gjykuar në ndeshjet ndërkombëtare.

Gjyqtarët e Kosovës sërish në Ligën e Kampionëve

Gjyqtarët e futbollit të Kosovës, Genc Nuza, Fatlum Berisha dhe Bujar Selimaj, janë deleguar që ta gjykojnë ndeshjen në Ligën e Kampionëve për të rinj, Stade Rennais (Francë)-Maccabi Petah Tikva (Izrael). Takimi në fjalë zhvillohet më 6 nëntor në orën 18:00 në Francë. Kujtojmë se këta gjyqtarë vlerësohen si më të mirët në futbollin e Kosovës.

Xhaka mund të rikthehet në ndeshjen ndaj Vitorias

Mesfushori shqiptar i Arsenalit, Granit Xhaka, pritet të kthehet të enjten në ekip kundër Vitorias në Ligën e Evropës. 27-vjeçari ka munguar në dy ndeshjet e fundit për shkak të incidentit me tifozët e Arsenalit, por "The Mirror" raporton se trajneri Unai Emery beson se ndeshja e radhës si mysafir të Vitoria është mundësia e përkryer për Xhakën që të ketë mundësi të luajë.

Hajdari: Gjilani, kampion vjeshtor

Fiton Hajdari në ndeshjen e fundit kundër Ferizajt ishte fytyra më e dashur e tifozëve të Gjilanit pasi arriti të shënojë tre gola në fitoren 4-0. "Jam i kënaqur me rezultatin që kemi arritur si skuadër. Për tre golat jam i lumtur sepse ishte hera ime e parë që shënova tre gola në një takim zyrtar, gjë që nuk ishte e lehtë por, falë ndihmës së ekipit, ia arrita", ka thënë Hajdari për "Olle". "Jemi duke u përgatitur maksimalisht për ndeshjet e mbetura në kampionat. Jemi duke shkuar ndeshje për ndeshje dhe mendoi se në fund do të jemi edhe kampion vjeshtor", ka deklaruar Hajdari. Gjilani, pas 13 xhirove, gjendet në pozitën e dytë me 27 pikë, dy më pak se lideri, Ballkani.

Gomesi operohet me sukses

LIVERPOOL, 4 NËNTOR - Skuadra e Evertonit ka dhënë informacionet e fundit në lidhje me dëmtimin e Andre Gomesit. Klubi anglez ka konfirmuar se futbollisti është operuar dhe

gjihtëçka ka shkuar mirë. Njoftimi zyrtar bën me dije se lojtari duhet të qëndrojë për pak kohë në spital, më pas do të dalë për ta nisur rikuperimin. Evertoni shkruan se Andre

Gomes do të rikthehet sërish pa probleme dhe në krahun tjetër ka falënderuar të gjithë tifozët dhe anëtarët e klubit që i kanë qëndruar afër në këtë periudhë. Gomesi u dëmtua në ndeshjen

kundër Tottenhamit. Son i ndërhyri nga mbrapa dhe portugezi u dëmtua keq duke thyer këmbën. Një ndër dëmtimet më të rënda që mund të jenë parë ndonjëherë në sport.



Dortmundi për hakmarrje ndaj Interit



DORTMUND, 4 NËNTOR - Borussia Dortmund pësoi humbje në Itali nga skuadra e Interit në kuadër të Ligës së Kampionëve (2-0), kurse sonte (e martë) kërkon hakmarrje për atë humbje. Të dyja klubet kanë nga katër pikë në Grupin F, tri pikë më pak se skuadra lidere, Barcelona. Skuadra e Dortmundit fitoi në fundjavë me rezultat 3-0 ndaj Wolfsburgut në Bundesliga dhe është ngritur në vendin e dytë, kurse fitore kërkon edhe ndaj Interit për t'i ruajtur shpresat për kualifikim në raundin e ardhshëm. Synime për rezultat të favorshëm në këtë ndeshje ka edhe skuadra e Interit sepse me trajnerin Antonio Conte po kërkon trofe. Në fundjavë kjo skuadër e mposhti Bolognan (1-2) me dy golat e shënuar nga

Romelu Lukaku. Paco Alcacer është rikthyer nga lëndimi, por nuk dihet se a do të jetë në njëmbëdhjetëshin e parë, kurse i gatshëm do të jetë Marco Reus. Jadon Sancho dhe Thomas Delaney do të rikthehen në formacion, derisa portieri Roman Burki dhe mbrojtësi Marcel Schmelzer mungojnë. Në formacionin e Contes mungojnë Alexis Sanchez, Danilo D'Ambrosio dhe Kwadwo Asamoah, por rikthehen Godin dhe Candreva. Ndryshe nga këto dy skuadra, Barcelona është favorite ndaj Slavia Prague në "Camp Nou", sepse edhe ndeshjen e kaluar arriti ta fitojë me rezultat 1-2. Fitoret e radhës në Grupin E i presin Liverpooli dhe Napoli në përballje me Genkun, përkatësisht Salzburgun.

GRUPI E		
21:00 Liverpool - Genk		
21:00 Napoli - Salzburg		
TABELA		PIKË
1. Napoli	3	7
2. Liverpool	3	6
3. Salzburg	3	3
4. Genk	1	1
GRUPI F		
18:55 Barcelona - Slavia Prague		
21:00 Borussia D. - Inter		
TABELA		PIKË
1. Barcelona	3	7
2. B. Dortmund	3	4
3. Interi	3	4
4. Slavia Prague	3	1
GRUPI G		
18:55 Zenit - Leipzig		
21:00 Lyon - Benfica		
TABELA		PIKË
1. Leipzig	3	6
2. Zeniti	3	4
3. Lyon	3	4
4. Benfica	3	3
GRUPI H		
21:00 Chelsea - Ajax		
21:00 Valencia - Lille		
TABELA		PIKË
1. Ajaxi	3	6
2. Chelsea	3	6
3. Valencia	3	4
4. Lille	3	1

Lakersi dhe Clippersi dominojnë në Perëndim

SAN ANTONIO, 4 NËNTOR - Vijon momenti i mirë në kampionat për skuadrën e Lakersit, që korri fitoren e pestë radhazi. Kalifornianët mundën 103-96 San Antonion jashtë fushës, ndeshje e dominuar nga miqtë. LeBron Jamesi realizoi një "triple double", me 21 pikë, 11 rebounde e 13 asistime, mbështetur edhe nga Davisi me 25 pikë e 11 rebounde, një dyshe që po bën diferencën në të gjitha takimet, raporton "Telesport". Fiton edhe skuadra tjetër e Los Anxhelosit, ajo e Clippersit, që triumfoi 105-94 ndaj Utah Jazzit, që bashkë me Lakersin kryesojnë renditjen në Perëndim. Fitore e vështirë për Clippersin, ku u dallua i zakonshmi Leonard me 30 pikë.



Miami, falë një loje të mirë kolektive (6 lojtarë mbi 12 pikë), arriti të triumfojë ndaj Houstonit me shifrat 129-100.

REZULTATET	
Indiana - Chicago	108-95
Miami - Houston	129-100
New York - Sacramento	92-113
San Antonio - Lakers	96-103
Cleveland - Dallas	111-131
Clippers - Utah Jazz	105-94

SHKURT

Casillasi rikthehet në stërvitje

Kur kanë kaluar gjashtë muaj nga koha kur pësoi një infarkt kardiak, portieri spanjoll Iker Casillas është rikthyer në stërvitje me Porton, ndonëse e ka bërë këtë për vetëm 25 minuta. Sipas raportimeve të përditshmes spanjolle "AS", ish-kampioni i botës dhe Evropës me Spanjën është stërvitur nën kujdesin e përgatitësve atletikë të skuadrës portugeze. Gardiani 38-vjeçar luan me Porton që prej verës së vitit 2015 dhe nuk ka ndërmend të ndalet as pas këtyre problemeve kardiace por, para se të kthehet në fushë, duhet ta marrë miratimin e mjekëve të skuadrës portugeze.

Hamiltoni fiton titullin e gjashtë në Formula 1

Piloti i Mercedesit, Lewis Hamilton, fitoi zyrtarisht për herë të gjashtë në karrierë titullin e kampionit të botës dhe për këtë i mjaftoi vendi i dytë në garën e Austinit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, garë që u fitua nga shoku i tij i skuadrës Valteri Bottas me Max Verstappen që kompletoi podiumin. Tashmë Hamiltoni, i cili në janar do të mbushë 35 vjeç, është vetëm një titull larg legjendës Michael Schumacher i cili numëron shtatë tituj botërorë në Formula 1.

Allegri refuzon Bayernin

Bayern Munchen e ka shkarkuar nga detyra e trajnerit Niko Kovaqin dhe menjëherë e ka kontaktuar për pasardhës të kroatit, trajnerin italian Massimiliano Allegri. Ky i fundit e ka refuzuar skuadrën gjermane me arsyen se dëshiron të pushoj deri në qershor. Lajmi është bërë me dije nga "Sky Sport Germania". Tash drejtuesit e Bayernit janë të detyruar për të gjetur një tjetër trajner, i cili mund të rikthejë skuadrën në rrugën e rezultateve pozitive.

Reali, 13 milionë euro për Salahin

Skuadra e Real Madridit është e gatshme ta transferojë yllin e Liverpolit, Mohammed Salah. "Don Balon" raporton se skuadra spanjolle e dëshiron sulmuesin egjiptian për edicionin e ardhshëm dhe është gati të ofrojë 130 milionë euro për ta bindur Liverpoolin të heqë dorë nga shërbimet e yllit të saj. 27-vjeçari ka luajtur edhe për Chelsea, Fiorentinën, Romën dhe Baselin.

Brescia shkarkon Corinin

Një tjetër trajner i shkarkuar në Serinë A. Bëhet fjalë për Eugenio Corinin. Humbja e djeshme ndaj Veronës ka rezultuar fatale për teknikun e Brescias, i cili mori drejtimin e "dallëndysheve" një vit më parë, teksa u shkarkua nga drejtuesit për rezultatet e dobëta. Humbja ndaj Veronës ishte e treta radhazi për Brescian, e cila në 11 javë kampionat ka arritur t'i sigurojë vetëm shtatë pikë. Alternativa e mundshme për ta zëvendësuar Corinin është trajneri uruguaiian Diego Lopez, i cili në të kaluarën ka drejtuar Cagliari dhe Bolognën.

Schweinsteigeri: Mulleri duhet të transferohet në Unitedin

Bastian Schweinsteiger beson se ish-bashkëlojtari Thomas Muller duhet ta konsiderojë mundësinë e transferimit në Manchester United. Spekulumet për gjermanin që mbetet i lidhur me një kalim në "Old Trafford" po vazhdojnë prej vitesh. Edhe Schweinsteigeri është i këtij mendimi, i cili ka thënë se edhe më herët "Djajtë e Kuq" janë munduar ta transferojnë. "Van Gaal dëshironte ta kishte në klub. Thomas ishte i ri në atë kohë dhe nuk dëshironte të largohej. Ndoshta ky mendim ka ndryshuar. Thomasi në kohën e fundit po qëndron në stol, por duhet të provojë diçka të re", ka deklaruar Schweinsteigeri.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nr. 01-111-154376
Datë: 04.11.2019

Në bazë të nenit 5 pika c. të Ligjit 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenit 66 paragrafi 1 dhe 3, nenit 64 paragrafi 1, nenit 67 paragrafi 5 dhe nenit 68, të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrarët Publik, nenit 8 dhe 10 paragrafi 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Udhëzimi Administrativ nr. 10/2018 (MASHT) - normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimi Administrativ nr. 05/2015 (MASHT) - normativi për arsimin profesional dhe Udhëzimi Administrativ nr. 07/2017 (MPMS) - rregullimi i procedurave në sektorin publik, UA nr.10/2015 për kontratën e punës për mësimdhënës të arsimit parauniversitar, Drejtoria Komonale e Arsimit në Prizren, shpallë:

K O N K U R S

Për vende të lira pune

Për kohë të pacaktuar:

Mësimdhënës për mësim klasor:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Heronjtë e Lumës”, Vërmicë.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Pjetër Budi”, paralelja në Dedaj.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Bajram Curri”, Romajë.
- Dy mësimdhënës në ShFMU “Hasim Maliqaj”, Poslisht
- Një mësimdhënës në ShFMU “Naim Frashëri”, paralelja Vlashnje.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Haziz Tola”, Prizren.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Hysni Temaj” Kushnin.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Hysni Temaj”, paralelja Travë.
- Një mësimdhënës në SHFMU “Brigada 125”, në Medvec
- Një mësimdhënës në SHFMU “Luigj Gurakuqi”, në Nashec
- Një mësimdhënës në ShFMU “Zef Lush Marku”, paralelja në Caparc

Kushtet:

- Fakulteti i Edukimit-programi fillor
- Fakulteti i Mësuesisë

Gjuhë shqipe:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Motrat Qiriazi”, Prizren
- Një mësimdhënës në ShFMU “Motrat Qiriazi”, Prizren, në paralelen Turke.

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Gjuhë gjermane:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Mati Logoreci”, Prizren 12 orë + ShFMU “Nazim Kokollari”, Prizren, 5 orë + ShFMU “Mustafa Bakiu”, Prizren 9 orë.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Fatmir Berisha” në Prizren 9 orë + ShFMU “Haziz Tola”, Prizren, 9 orë.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Bajram Curri”, Romajë 8 orë + ShFMU “Pjetër Mazrreku”, Mazrek, 6 orë + ShFMU “Krusha e Vogël”, Krushë e Vogël 3 orë.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Ekrem Rexha”, Lubizhdë, 8 orë + ShFMU “Abdyll Frashëri”, Prizren, 7 orë.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Deshmoret e Hasit” 3 ore , “Brigada 125” 3 orë , “Luigj Gurakuqi” 4 ore dhe Shfmu “Naim Frasherit” 7 orë.

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

TIK:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Mit’hat Frashëri”, Krajk 16 orë.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Motrat Qiriazi”, Prizren.
- Një mësimdhënës në SHFMU “Brigada 125”, 10 orë mësimore

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar

-Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Matematikë:

- Një mësimdhënës në SHFMU “Zef Lush Marku”, në Velezhë, 10 orë
- Lidhja e Prizrenit 15 orë

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Edukatë muzikore:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Ibrahim Fehmiu”, Prizren.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Haziz Tola”, Prizren.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Fatmir Berisha”, Prizren 12 orë
- Një mësimdhënës në SHFMU “Xhevat Berisha” për 10 orë dhe në SHFMU “Sinan Thaçi” në Zojzë, 4 orë

Kushtet:

- -Niveli master arsimor-Pedagogji e përgjithshme muzikore, Fakulteti i Edukimit (300 ECTS ose 360 ECTS)
- -Sistemi katërvjeçar
- -Baçelor - Pedagogji e përgjithshme muzikore (240 ECTS)

Psikologji:

Një mësimdhënës në gjimnazin “Remzi Ademaj” Zhur 4 orë dhe 4 orë në gjimnazin “Remzi Ademaj”, Velezhë.

Kushtet:

- -Niveli master arsimor, Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- -Sistemi katërvjeçar
- -Baçelor – (katërvjeçar 240 ECTS)

Biologji:

- Një mësimdhënës në SHFMU “Heronjtë e Lumës” në Vërmicë, 16 orë

Kushtet:

- Niveli master arsimor, Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Edukatë Qytetare

- Një mësimdhënës në ShFMU “Bajram Curri”, në Prizren

Kushtet:

- Niveli master arsimor, Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Për kohë të caktuar:

Mësimdhënës për mësim klasor:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Dëshmorët e Zhurit”, Zhur. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).
- Një mësimdhënës në ShFMU “Mati Logoreci”, Prizren. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).
- Një mësimdhënës në ShFMU “Xhevat berisha”, Prizren. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).
- Një mësimdhënës në ShFMU “Luigj Gurakuqi” në Nashec me kohë të caktuar deri më 31.06.2020.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Motrat Qiriazi”, Prizren. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).
- Një mësimdhënës në ShFMU “Motrat Qiriazi”, Prizren. (Zëvendësim për pushim mjekësor)
- Një mësimdhënës në ShFMU “Dy Dëshmorët”, Piranë. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).
- Një mësimdhënës në ShFMU “Lidhja e Prizrenit”, Prizren. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).

Kushtet:

- Fakulteti i Edukimit-programi fillor
- Fakulteti i Mësuesisë

Edukator/e:

- Një edukator në ShFMU “Dëshmorët e Hasit”, Kabash. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).

Kushtet:

- -Fakulteti i Edukimit-programi parashkollor
- -Shkolla e lartë pedagogjike- drejtimi për edukatore
- Fakulteti filozofik- dega e pedagogjisë së përgjithshme
- Fakulteti i Shkencave Sociale-programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve

Gjuhë shqipe:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Shtjefën Gjeqovi”, Zym, 19 orë mësimore. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Gjuhë angleze:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Shtjefën Gjeqovi”, në Bregdri, 16 orë mësimore. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).
- Një mësimdhënës në ShFMU “Abdyl Frashëri”, Prizren. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).
- Një mësimdhënës në SHFMU “Pjetër Mazreku” 14 orë mësimore. (Zëvendësim për pushim të lehonisë)

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

TIK:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Pjetër Budi” në Lugishtë të Hasit, (Zëvendësim për pushim të lehonisë).
- Një mësimdhënës në ShFMU “Nazim Kokollari”, Prizren për 14 orë + 4 orë matematikë me kohë të caktuar deri më 04.03.2020.
- Një mësimdhënës në ShFMU “Lidhja e Prizrenit” për 7 orë mësimore dhe SHFMU “ Abdyl Frashëri” 10 orë
- Një mësimdhënës i TIK në SHFMU” Heronjë e Lumës” 10 orë

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Matematikë:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Xhevat Berisha”, Prizren 10 orë. (Zëvendësim për pushim të lehonisë).
- Një mësimdhënës në SHFMU “ Zenun Çoçaj”

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Biologji:

- Një mësimdhënës në ShFMU “22 Dëshmorët”, Randobravë 12 orë deri më 31.12.2019.

Kushtet:

- Niveli master arsimor, Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Art figurativ:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Abdyl Frashëri”,

Kushtet:

- -Niveli master arsimor, Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- -Sistemi katërvjeçar
- -Baçelor – (katërvjeçar 240 ECTS)

Kimi-Fizikë:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Ibrahim Fehmiu”, Prizren, (Zëvendësim për pushim të lehonisë)
- Një mësimdhënës në ShFMU “Dy Dëshmorët”, Piranë, (Zëvendësim për pushim të lehonisë)

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Histori:

- Një mësimdhënës në ShFMU “Dëshmorët e Hasit”, 12 orë (kohë të caktuar deri më 31.08.2020)

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Gjeografi:

- Një mësimdhënës në ShFMU “ Abdyl Frashëri ”, (kohë të caktuar deri më 31.08.2020)

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Edukatë fizike:

- Një mësimdhënës ShFMU “Ibrahim Fehmiu” 20 orë (kohë të caktuar deri më 31.08.2020)

Kushtet:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Puna provuese:

- Për pozitën me afat të pacaktuar, periudha provuese është 6 muaj;
- Për pozitën me afat të caktuar, periudha provuese është sa 1/5 e kohës së përcaktuar .

Dokumentacioni i kërkuar për të gjitha pozitën e lartpërmendura:

- Fotokopja e vërtetuar e diplomës (Formati A4);
- Nostifikimin, nëse kandidati e ka të kryer shkollimin jashtë Kosovës.
- Vërtetim mbi përvojën e punës dhe së bashku me vërtetime edhe pasqyra e trustit pensional; (nëse ka)
- Trajnimet profesionale.
- Certifikata e lindjes;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore, kandidati e sjell pasi të pranohet në punë.
- Certifikatat që nuk jeni nën hetime;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikata të ndryshme.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data e publikimit më **04.11.2019** deri më datën **18.11.2019** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Instrukcione Aplikimi: Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në <http://kk.rks-gov.net/prizren/Shpalljet/Konkurset.aspx>, dhe pas plotësimit sipas çdo pike të aplikacionit, i bashkëngjitni dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni tek ne drejtpërdrejtë -Adresa jonë: në sportelin e pranimit nr. 2, në objektin e administratës komunale në Komunën e Prizrenit, rr. “Remzi Ademaj” p.n. -Prizren.

VËMENDJE: Njoftimet i gjeni në Ueb, ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 44715 prej orës 08:00 – 16:00.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Request for Expression of Interest

Country: Kosovo
 Project ID: P147402
 World Bank Loan/Credit Name: Kosovo Health Project
 Ref. No.: PM 16

Follow-up survey on expectation and perception of population towards quality of services in Primary Health Care; and their expectation of the population regarding Outpatient Drug Benefit Scheme

Background:

On March 26, 2015 the Assembly of Republic of Kosovo approved the Financial Agreement between the Kosovo Government and the International Development Association. The Kosovo Health Project (KHP), restructured in May 2018, is worth US\$ 15.69 million. Its objective is to contribute to (i) developing the building blocks to introduce Social Health Insurance (SHI); and (ii) strengthening primary health care (PHC) in selected municipalities.

The project consists of three components:

Component 1: Support capacity building and establishment of building blocks for introduction of Health Insurance Fund (HIF).

Component 2: Support Primary Health Care (PHC) strengthening.

Component 3: Project management and communications.

Objectives:

Conduct a follow-up survey with the findings intuitively understandable for policy makers on (i) patients' perception of quality of services at the Primary Health Care level; (ii) patients' expectations regarding the Outpatient Drug Benefit scheme and (iii) comparative analyses of the baseline data and follow-up data.

Considering the baseline survey methodology used, the survey at national level will use quantitative analysis methods to follow-up on:

1. Perception of quality of services in Primary Health Care;
2. Expectations (wishes) of the citizens for improved services (desired level of health care services) with emphasis on beginning of the Outpatient Drug Benefit scheme (reimbursable drugs & expendables scheme); and
3. Comparative analyses of the baseline data and follow-up data.

Scope of work

The consultant's responsibilities include the following:

Survey design and development of questionnaire

Based on available information and previous research and surveys, the consultant will elaborate hypotheses related to each of the above mentioned issues, and discuss the hypotheses and survey questions with the technical group comprising the HIF, MoH, and the National Institute of Public Health. Based on these discussions, the consultant will draft a survey instrument to be administered to the health providers and public. For comparison purposes, the methodology used in the baseline survey will be considered, and an appropriate sample size among the target population groups and subgroups will be selected. The consultant will also discuss with the aforementioned working group additional qualitative techniques and facility observation in order to supplement the information collected through the questionnaire. The consultant will test the instruments in one or two primary health care facilities and their patients.

The consultant will make the necessary modifications/improvements to the survey instruments and finalize these.

Data collection

The questionnaires will be administered by a group of surveyors. The head of the local consultant team will be in charge of all logistic issues related to the implementation of the survey in the field; data entry and generation of data files. Data should be processed with SPSS or similar software. Primary data files with survey results must be supplied to the Client.

Data analysis

The consultant will apply relevant statistical methods and/or logical techniques to evaluate, categorize, tabulate, and illustrate the data obtained from the survey to discover underlying patterns and trends. The following data analyses are expected:

- Descriptive analysis
- Comparative analysis

Qualifications Required (Profile of consultant/qualifications)

The research company should have:

1. At least 5 years of experience in producing similar surveys and conducting researches;
2. Experience with both qualitative and quantitative data collection and analysis techniques;
3. At least one contract successfully completed for similar research assignment within last 5 years;
4. Capacity and availability of resources to carry out the required work for the required period of time;
5. Ability to mobilize bi-lingual (Albanian and Serbian) teams of surveyors and focus group moderators.

Key personnel required expertise

The Consultant Team should consist of at least three core members: a) a team leader and researcher; b) a first research assistant; and c) a second research assistant. The complete team should offer the following qualifications:

1. Team leader: advanced degree in public health, health economics, medical studies, social sciences, or other relevant field (Masters or PhD); five years of working experience in the design and implementation of studies and surveys, and in particular in the use of semi-structured interviews, observations, focus groups and/or other group judgment techniques;
2. Research assistants: advanced degree in public health, health economics, medical studies, social sciences, or other relevant field (Masters or PhD); and minimum of three years of experience in the design and implementation of studies and surveys, and in particular in the use of semi-structured interviews, observation, focus groups and/or other group judgment techniques.

Timeframe and Deliverables:

The foreseen contract duration is estimated four months while the estimated input for this assignment is eight man-months.

The consultant firm will submit the preliminary and the final report with the results of the survey, comparisons with the results of the baseline survey, and recommendations.

Selection process:

Consultant will be selected in accordance with the procedures set out in the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers published in January 2011 (Consultants Guidelines), according to selection based on **Consultants Qualifications (CQ) method**.

Interested companies may obtain further information or detailed ToR for this assignment at the e-addresses below.

Expression of interest may be submitted to the below stated address until **18 November 2019**

Ministry of Health,

Afrim Bajrami, Procurement Specialist

Address: Ministry of Health Rr. Zagrebit p.n.

10 000 Prishtinë, Republic of Kosovo

E-mail: To : afrim.bajrami@rks-gov.net

E-mail: Cc : Fatime.Arenliu.Qosaj@rks-gov.net



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L